

Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi

KËTO LLOGARITEN FURNIZIME

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

ZOTI KA KRIJUAR GJITHËSINË DHE KA PARAPARË
FURNIZIMET PËR TË

Për çka do të pyesin njerëzit?

Njerëzit mund të pyesin:

Pse Zoti e ka caktuar njeriun mëkëmbës në tokë?

(Pse) Disa të aftë, disa të paaftë?

(Pse) Ky jep, tjetri merr?

Pse nuk i ka bërë që të gjithë të aftë?

Ne u themi: Dallimet janë masë e matjes së çështjeve të cilat e plotësojnë peshojën.

Kemi natën, kemi ditën. Por a mos është nata e kundërta e ditës?

Jo! Nata e plotëson ditën dhe dita e plotëson natën. Po mos t'i kishte krijuar që të dyja së bashku, atëherë do të humbej balanca (ekuilibri) e gjithësisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ اللَّيْلَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ مَنْ إِلَهُ غَيْرُ اللَّهِ
يَأْتِيكُمْ بِضِيَاءٍ أَوْ لَا تَسْمَعُونَ ﴿٧١﴾ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ النَّهَارَ
سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ مَنْ إِلَهُ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بِلَيْلٍ تَسْكُنُونَ فِيهِ أَوْ لَا
تُبْصِرُونَ ﴿٧٢﴾

“Thuaj (O Muhamed): Pa mendoni, nëse Allahu ua bën natën të përhershme deri në Ditën e gjykimit, cili zot, pos Allahut do t’ua sillte ditën që bën dritë, a nuk dëgjoni? Thuaj: Pa mendoni nëse Allahu ua bën ditën të përhershme deri në Ditën e gjykimit, cili zot pos Allahut do t’ua sillte natën, në të cilën qetësoheni? A nuk po shihni? (Kasas : 71, 72)

Për këtë arsye, njeriu, që të punoj, ka nevojë për dritën e ditës dhe, që të pushoj, ka nevojë për errësirën dhe qetësinë e natës. Nëse njeriu nuk flenë dhe nuk pushon, ai nuk mund të punoj. Me këtë, ne e vërtetojmë se nata dhe dita e plotësojnë (komplementojnë) njëra-tjetrën dhe nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën.

A janë krijesat komplementar (plotësues) të njëra-tjetrës, apo janë të barabarta?

Kur është në pyetje mashkulli dhe femra, njerëzit nuk e kuptojnë se mashkulli dhe femra janë komplementar të njëri-tjetrit, por nga padija apelojnë që të bëhet barazimi i femrës me mashkullin.

Ne u themi: Ju mendoni se mashkulli dhe femra janë dy gjini të ndryshme, por në të vërtetë ato janë krijuar prej një gjinie dhe janë ndarë në dy lloje, ku secili lloj ka detyra dhe specifika me të cilat dallohen nga njëri-tjetri. Në bazë të këtyre detyrave dhe specifikave, këto dy lloje bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Lexojeni thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰ ۖ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّىٰ ۖ

“Pasha natën që mbulon (me errësirë) dhe pasha ditën që agon (me ndriçim).” (El Lejl : 1, 2)

Zoti i Lartmadhëruar i ka përmendur dy çështje që janë komplementar të njëri-tjetrit. Ai i cili nuk flenë dy apo tri ditë, patjetër se duhet të flejë dy apo tri ditë, që ta mbush zbrazëtirën, dhe që më pastaj të jetë i gatshëm të vazhdoj punën e tij. Të shohim thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰ ۖ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّىٰ ۖ وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ۚ

“Pasha natën që mbulon (me errësirë) dhe pasha ditën që agon (me ndriçim) dhe për atë që ka krijuar mashkullin dhe femrën.” (El Lejl : 1-3)

Mashkulli dhe femra janë si nata dhe dita, dy të ndryshme të cilat e plotësojnë njëra-tjetrën, e ti mos i konsidero armiq (të kundërt), por këtë çështje shikoje në prizmin e komplementimit (plotësimit) mes tyre, sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّىٰ ۖ

“Vërtetë angazhimi i juaj është i shumëllojtë.” që do të thotë se secili ka detyrë të veçantë në jetë.

Në këtë ka urtësi

Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë urtësi në krijesa, ashtu që çdo gjë t'i shërbejë njeriut: të ngurtat, bimët dhe kafshët. Kjo është bërë që njeriu t'i përgjigjet planprogramit të Allahut dhe ta adhuroj Atë. Mirëpo, urtësinë të cilën Allahu e ka paraparë në sende, nuk i përgjigjet (nënshtrohet) njeriut derisa njeriu ta kuptojë atë se kjo botë nuk është e nënshtruar (në shërbim) për shkak të tyre (fuqisë së njerëzve) por i është nënshtruar njeriut prej fuqisë së Allahut të Lartmadhëruar:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَيْطَغَى ﴿٦﴾ أَنْ رَّأَاهُ اسْتَغْنَى ﴿٧﴾

“Por, padyshim se njeriu e tejkalon çdo kufi të krimit, kur e mendon veten se është i pavarur (në tërësi).” (El Alek : 6, 7)

Vogëlushi mund ta drejtoj devenë e madhe, ndërsa njeriu i madh nuk mund të afrohet dhe ta kap gjarprin e vogël. Pas kësaj, **urtësia** (arsyeja e shëndoshë) na qon drejt asaj që, njeriu ta ndjej se aftësia dhe fuqia e tij, është prej Allahut të Lartmadhëruar dhe jo prej vetes së tij. Për këtë arsye, Allahu krijon njerëz të dobët, të cilët nuk mund të fitojnë pasuri për të jetuar, e me këtë ka dashur që të na e tërheq vëmendjen në atë se forca e të fortëve është dhuratë prej Allahut, e jo prej vet njeriut, sepse po të ishte prej njeriut, atëherë nuk do të kishte pasur asnjë të paaftë në tokë.

Kur i forti e kupton se forca e tij është dhuratë prej Zotit, dhe e kupton që këtë forcë mund t'ia merr dhe të bëhet i dobët sikurse të dobëtit e tjerë që i sheh para tij, siç janë:

- I dobëti i cili nuk mund të punoj,
- i verbri i cili nuk mund të fitoj,
- i zbathuri i cili nuk mund të ecë, etj..

Të gjithë këta ekzistojnë, për arsye që tu tërhiqet vërejtja të shëndoshëve dhe të fortëve, se shëndeti dhe forca janë dhuratë prej Allahut dhe që të mos mashtrohen dhe të bëjnë mëkate, por që të frikohen dhe të jenë të kujdesshëm për faktin se Allahu është Ai i cili jep dhe Ai është i Cili merr.

Burimi i aktivitetit njerëzor

Zoti i Lartmadhëruar me urtësinë e Tij e ka paraparë që furnizimet të shpërndahen në mesin tonë, në mënyrë që aktiviteti ynë të jetë sa më efektiv. Nëse çdonjëri nga ne do t'i kishte kushtet e mira të jetesës, atëherë kush do t'i pastronte rrugët, kush do t'i rregullonte kanalizimet, kush do t'i bartte blloqet dhe çimenton për ndërtimin e ndërtesave. Nëse secili nga ne do të kishte pasuri, asnjëri nga ne nuk do të dëshironte t'i kryente ato punë. Mirëpo, Zoti i Lartmadhëruar këto punë i ka ndërlidhur me rizkun (furnizimin), ashtu që t'i kryejnë ato punë, që të sigurojmë ushqim për fëmijët tanë, sepse përndryshe askush nuk do ta merrte fshesën për të pastruar rrugët, askush nuk do të punonte në rregullimin e ujës-jellësit. Për këtë arsye, ata të cilët i kryejnë këto janë të lumtur, bie fjala, kur të rregullojnë ujës-jellësin ose kur ta shohin rrugën e pastër, mirëpo, a mbetet situata vetëm kështu.? Jo. Ditët ndryshojnë në mes të njerëzve, secili njeri e ka ditën e vet dhe secili e plotëson dëshirën në kohën e vet. Për këtë arsye, me kalimin e ditëve, këto punë fizike bëhen burim i furnizimit të mjaftueshëm dhe u mundëson njerëzve që të posedojnë pasuri, banesa, automjete të shtrenjta, etj., ndërsa ndodh që ata që kanë diploma të universiteteve të kenë të ardhura më të vogla dhe furnizim më të dobët.

Bota, që të plotësohet, ka nevojë për dhunti të shumta. Ti, nëse dëshiron ta ndërtosh një shtëpi, të nevojitet inxhinieri, punëkryerësi, zdrukthëtari, armiruesi, muratori, etj.. Një njeri, i vetëm, nuk mund t'i ketë të gjitha këto dhunti, për këtë arsye, patjetër duhet ta plotësojnë njëra-tjetrën dhe të ndërlidhen me njëra-tjetrën për të siguruar ekzistencën dhe furnizimin. Për këtë arsye, dyert të cilat i prodhon zdrukthëtari, pasi që puna e tij është i ndërlidhur me furnizimin e tij, ai mundohet t'i prodhoj me sa më kualitativ, përderisa derën të cilën e prodhon për shtëpinë tij, nuk e bën tepër kualitativ sepse nuk e konsideron se është e ndërlidhur me furnizimin e tij.

Besimi

Njeriu duhet patjetër ta dijë se nuk është paraardhës (burim) i gjithësisë, por është i ardhur dhe mëkëmbës në të. Shkatërrimi i tokës fillon kur njeriu e llogarit veten se është paraardhës i saj. Kujdes, mos mendo se ai i cili jep është më i vlefshëm se ai i cili merr, ose ai i cili merr është më i vlefshëm se ai i cili jep, por që të dy janë të njëjtës vlerë.

Besimi (imani) është 50-50. Gjysma e imanit është **falënderimi**, gjysma tjetër është **durimi**. Ti ose je i begatuar dhe falënderon, ose je i privuar dhe duron. I pasuri i cili është pronar i të mirave materiale, e ka marrë me vete gjysmën falënderuese dhe është privuar nga gjysma duruese. Për këtë arsye, është urdhëruar që të jep nga pasuria të cilën e ka arritur me djersë dhe nga puna e dorës së tij, e këtë dhënie të pasurisë e arrin me durim. Kësisoj rregullohet edhe çështja e të varfrit. Nëse më herët e ka marrë gjysmën duruese, tash kur ta merr pasurinë e të pasurit pa shpenzuar mund, e falënderon Allahun për begatitë e Tij, dhe me këtë e kompletton edhe gjysmën falënderuese. Me këtë e pamë se, me zbatimin e planprogramit të Allahut, mund të përmbushet besimi (imani), i cili është gjysma falënderim dhe gjysma durim.

Kur jep i pasuri, atëherë i paafti për fitim e shtyp hidhërimin e tij, sepse Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë pa ndier mundim dhe lodhje, ndërsa i pasuri hulumton se ku duhet të jepet zekati dhe i kërkon të varfrit që tu jep atyre.

Kujt i jepet pasuria?

Nëse e do një njeri, ti i jep nga pasuria që ke, por nëse nuk ke, ti hyn në borxh dhe i jep. Pra, nuk e lë pa i dhënë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضْعِفُهُ لَهُ وَأُضْعَافًا كَثِيرَةً وَاللَّهُ يَقْبِضُ وَيَبْصُطُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢٤٥﴾

“Kush do t’i jap Allahut hua, huazim të mirë. Ai di t’ia kthej atij me fitim të shumëfishtë. Allahu edhe e ngushton furnizimin, por edhe e shton. Tek Ai do të ktheheni.” (El Bekare : 245)

Pse Zoti i Lartmadhëruar thotë **“...kush do t’i jap Allahut hua...”** kur dihet se pasuria është e Allahut?

Ne themi: Padyshim se Allahu e respekton punën e njeriut dhe pasurinë që e fiton. Por, ka kërkuar që prej asaj pasurie t'i jep vëllait i cili ka nevojë, dhe këtë dhënie ta konsideroj si dhënie drejtuar Allahut, e e gjithë kjo, vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut. Kjo i bie se, ai i cili i jep nevojtarit, i ka dhënë hua Allahut. Njësoj sikurse baba i cili e cakton arkën e kursimeve për fëmijët e tij, dhe ia cakton secilit fondin e kursimeve, e pastaj kur të paraqitet gjendje e vështirë ekonomike, shkon secili fëmijë dhe kërkon nga baba që t'i tërheq kursimet e tij. Mirëpo, pasuria e fëmijëve është pasuria e babës e marrë në konsideratë, sepse ua ka dhuruar fëmijëve dhe pastaj e ka llogaritur si pasuri të tyre.

A huazon i varfri?

Zoti i Lartmadhëruar e respekton dhe e çmon punën e njeriut dhe pasurinë e quan pasuri të tij (njeriut) dhe ka kërkuar nga ai që të huazoj. Në këtë çështje ka specifika të veçanta për dy persona të veçantë:

- I pasuri – specifika e tij është se, ai jep për Allah;
- I varfri – specifika e tij është se, Zoti i Lartmadhëruar ka marrë hua për të.

Allahu, zekatin e ka bërë shtyllë prej shtyllave të islamit, dhe këtë shtyllë e ka bërë për dobinë e të varfrit.

I pasuri, nuk është shtyllë në besimin e të varfrit, ndërsa i varfri është shtyllë në besimin e të pasurit.

Kur i pasuri i jep të varfrit një pjesë të pasurisë së tij, ai pavarësohet nga ajo pjesë. Ka dallim në mes të:

- pavarësimi prej një çështjeje dhe
- pavarësimi në çështje.

Zoti i Lartmadhëruar është i pavarur prej gjithësisë dhe çdo gjëje në të, andaj ky pavarësim i të pasurit është sikurse t'i ketë dhënë Allahu cilësi prej cilësive të Tij, sepse me dhënien, ai pavarësohet nga e gjithë pasuria e kësaj bote.

Pasuria nuk është produkt i vlefshëm, e cila ka vlerë të drejtpërdrejtë për njeriun. *Shembull:* Nëse një njeri ka një kodër me ari dhe është ulur në një pjesë të shkretëtirës, nuk ka asnjë pjesë të vogël buke, e nuk ka as ujë. Çfarë vlere do të kishte ajo kodër me ari për të?

Vlera e saj është e barabartë me zero.

Pra, mund të konstatojmë se pasuria nuk është qëllim, por është mjet. Kur i pasuri e pengon (nuk ia jep të varfrit) të varfrin nga pasuria e tij, atëherë ai pasurinë e tij e ka bërë *qëllim* dhe kështoj pasuria e tij nuk i bën dobi të plotë. E kundërta e këtij është ai i cili ka një kodër me ari, i cili nuk ka asnjë pjesë buke, mirëpo, në momentin kur i jep pasuri të varfrit, atëherë pasurinë e ka bërë *mjet* dhe pasuria e cila deri më tash ishte e padobishme bëhet e dobishme. Kjo është detyra e pasurisë në jetë. Ti, me pasuri blen atë që beson se të bën dobi dhe pasurisë duhet t'ia japësh detyrën e cila më së shumti të bën dobi, e ajo është: **Shpërblimi dhe kënaqësia e Allahut të jetë mbi ty.**

Puna dhe aftësia

Zoti i Lartmadhëruar e respekton aktivitetin e njeriut në punë, dhe kërkon që secili njeri të punoj në bazë të aftësisë së tij, e jo në bazë të nevojës së tij. Po të punonte secili njeri në bazë të nevojës së tij, nuk do të kishte pasur tepricë për dhënie të zekatit nga pasuria e fituar. Për këtë arsye, pasurinë të cilën e fiton njeriu në këtë botë, Zoti e konsideron pasuri të njeriut, me qëllim që secili nga ne të punojë në bazë të aftësisë që ka. Pasuria është pasuri personale dhe kur të kesh tepricë nga pasuria jote e cila është mbi nevojat e tua, atëherë ti nuk ke dëshirë që pasuria e tepërt të largohet nga ju, ndërsa, në të njëjtën kohë dëshiron të shpenzosh në atë që të bën dobi, e duhet ta dish se shpenzimi më i mirë i cili të bën dobi është që të punosh për jetën tënde në botën tjetër.

Kështu pra, ti, ke nevojë për pasuri tepricë (shitesë) që të japësh zekatin dhe sadakanë, me qëllim që të sigurosh jetën tënde të botës tjetër, ndërsa i varfri ka nevojë për pasurinë tënde tepricë (shitesë), që me atë pasuri të jetojë në këtë botë. Kështu, secili ka nevojë për njëri-tjetrin, mirëpo, Zoti i Lartmadhëruar e respekton punën e njeriut dhe të pasurit i ka dhënë mundësi të fitoj sasi më të madhe se sa i nevojitet (për këtë botë), ndërsa të varfrit i ka dhënë më pak se sa i nevojitet.

- Nëse njeriu e gjen një thesar, zekati për të është 20%;
- Nëse njeriu mbjell, punon dhe e korrë, zekati për të është 10%;
- Nëse është në valutë të punës ditore, si f.v.: në tregti, zekati për të është 2.5%.

Kjo është kështu, nga shkaku se, sa më shumë angazhohet njeriu në punën e tij, përqindja e zekatit është më e vogël. Sa më pak angazhohet njeriu në punën (fitimin) e tij, përqindja e zekatit është më e madhe. Kjo, nga shkaku se Zoti i Lartmadhëruar dëshiron ta stimuloj njeriun të punojë, sepse shoqëria përfiton nga puna e tij edhe nëse njeriu (punëtori) nuk e ka atë qëllim.

Interesi i përgjithshëm

Njëri e ndërton një ndërtesë, nga ajo ndërtesë të gjithë përfitojnë, qoftë edhe nëse pronari nuk ka qenë i vetëdijshëm që me këtë ndërtim përfiton shoqëria. Disa njerëz mendojnë se vetëm puna sjell pasuri, ndërsa harrojnë se Allahu është Ai i cili ua ka mundësuar dhe ua ka lehtësuar atë punë. Mos të harrojmë se, ndonjëherë frynë erë e fortë dhe i dëmton të lashtat e me këtë e hedh poshtë mundin e atyre të cilët i kanë mbjellë dhe ujitë, dhe kështu mbesin duarthatë. Kjo na bën me dije se, çdo gjë plotësohet dhe realizohet me dëshirën e Allahut dhe jo domosdoshmërisht me pasimin e shkaqeve.

Kur Zoti i Lartmadhëruar e shfaron një pjesë të të lashtave të ndonjë vendi, ai e bekon dhe e shton në një vend tjetër. Nëse në një vend shkatërrohen arat e misrit, në një vend tjetër shtohet prodhimi i misrit, kështu që banorët e vendit ku janë shkatërruar të lashtat blejnë nga banorët e vendit tjetër (ku është shtuar prodhimi), ose edhe shteti i cili ka realizuar misër tepricë, i dërgon ose si ndihmë ose si mbështetje vendit të cilit i janë shkatërruar arat e misrit. Pra, në këtë mënyrë nivelohet jeta dhe bëhet barazimi shoqëror.

Pastrim (kujtim) nga pakujdesia (harresa)

Zoti i Lartmadhëruar është Krijuesi i shpirtit njerëzor, dhe Ai e di se çka ka në zemrat e tyre. Allahu i Lartmadhëruar ia tërheq vërejtjen të aftit, që të ndaj nga fitimi i tij dhe t'ia jep të paaftit.

Ne jetojmë në botën e konkurrencës dhe xhelozive.

Është e mundur që i afti i sodit, të bëhet i paafti i së nesërme. Për këtë arsye, soditja në të paaftin, krijon brengë në zemrën e njeriut të aftë dhe e bën që t'i kujtoj begatitë që ia ka dhuruar Allahu. Me të kuptuar këtë, i afti shpejton që të jap prej pasurisë së tij dhe kënaqet kur jep, sepse frikësohet se mos do të bëhet i paaftë sikurse ai. Nëse e shohim thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا وَصَلِّ عَلَيْهِمْ إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ
لَّهُمْ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٣﴾

“Merr nga pasuria e tyre zekatin, me qëllim që t'i pastrosh ata dhe t'i bësh të çiltër.” (Et-Tevbe : 103)

Ne e shohim se, sadakaja:

- e pastron (e këndell) njeriun nga pakujdesia e cila e kaplon; dhe
- e pastron shpirtërisht.

Zoti i Lartmadhëruar, kur e ka obliguar zekatin, e cila është pjesë shtesë që del nga dora e të pasurit për tek dora e të varfrit, këtë dhënie e ka titulluar *shtim pasurie*, edhe pse për nga aspekti i jashtëm është pakësim. Të supozojmë se pasuria jote qëndron tek ti gjatë gjithë jetës, sado që të zgjasë jeta jote prapëseprapë është e shkurtër, dhe patjetër se do të vij dita kur ti do të ndahesh nga ajo pasuri, e kjo ndodh me vdekjen tënde. Në atë moment, atë pasuri që e ke fituar dhe e ke grumbulluar, e humb; ndërsa atë që e ke dhënë sadaka, vazhdon të mbetet me ty, që të të shoqëroj në botën tjetër, pra, mbetet me ty në botën e përgjithmonshme, as nuk i ndahesh, as nuk të ndahet, dhe në të njëjtën kohë, Zoti i Lartmadhëruar ta shumëfishon. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë (në hadith kudsij):

“Njeriu thotë: Pasuria ime, pasuria ime!

E, nuk është pasuri e jotja, pos asaj që:

- e ke ngrënë dhe e ke shpenzuar;
- ose e ke blerë veshmbathjen dhe e ke harxhuar;

- ose ke dhënë sadaka, dhe të ka mbetur.

Dashuria në pasuri

Ai i cili e do pasurinë e tij, e do që të jetë me të për kohë të gjatë, do që ta kalojë jetën me të dhe do që t'i arrij në botën tjetër, në shtëpinë e përgjithmonshme. Pra, ai që dëshiron që pasuria e tij të qëndroj me të edhe në botën tjetër, le të investoj në sadaka për hir të Allahut.

Pejgamberit s.a.v.s. i ka ardhur një dele dhuratë dhe ai s.a.v.s. i thotë Aishes r.a.:

“Merre mishin e saj dhe jepe sadaka. Aishja r.a. e ka ditur se pejgamberi s.a.v.s. e ka dashur mishin e shpatullës, kështu që tërë mishin e deles e ka shpërndarë sadaka, ndërsa e ka ndaluar pjesën e mishit të shpatullës.

Pastaj, kur e ka pyetur Muhamedi s.a.v.s.: - Si ke vepruar me mishin e deles?

Ajo i thotë: - Të tërën e kam dhënë sadaka dhe e kam ndaluar vetëm mishin e shpatullës së saj.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - Thuaj: E kam ndaluar të gjithë mishin e deles, përveç mishin e shpatullës së saj, sepse, oj Aishe, atë që e ke dhënë sadaka na ka mbetur, e atë që e ke ndaluar, do të harxhohet.”

I dërguari i Allahut s.a.v.s. gjithmonë çështjet i ka emërtuar në bazë të qëllimit dhe esencës së tyre. Ai i cili dëshiron që pasuria ta shoqërojë edhe në botën tjetër, le t'i jap sadaka të varfrit dhe nevojtarit. Kur një njeri e ka pyetur Aliun r.a.:

- Dëshiroj të di për veten time, a jam njeri i kësaj bote apo i botës tjetër?

Imam Aliu r.a. i është përgjigjur:

- Përgjigjja është tek ti dhe jo tek unë, shikoje veten, kur të vjen ndonjë njeri i cili vjen tek ti dhe të jep diçka dhe një njeri tjetër i cili vjen tek ti dhe kërkon diçka, cilin prej tyre e do më shumë, dhe cilin prej tyre e mirëpret më mirë.

- Nëse e do atë i cili merr nga ti, atëherë ti je i botës tjetër.

- Nëse e do atë i cili të jep, ti je njeri i kësaj bote (e do këtë botë), sepse ai i cili merr nga ti, të mirat e tua t'i bart në botën tjetër dhe është mjet për të ta shtuar pasurinë atje. Ndërsa ai i cili të jep, të shton pasurinë në këtë botë dhe nuk të jep asgjë për botën tjetër.

Bota jote është aq sa është jeta jote

Atyre të cilët e duan pasurinë, u themi: Me pasurinë vepro në atë mënyrë që ajo të qëndroj me juve për një kohë të gjatë. Kjo botë nuk është njësi matëse e jotja, por për ty kjo botë është aq sa do të jetosh në të, kurse në botën tjetër do të jetosh gjithmonë në të.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu është i Ditur, i Urtë.” që do të thotë: Allahu i vendos gjërat në vendet e tyre, me dituri dhe urtësi. Këtë e bazojmë në thënien e Tij:

أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ﴿١٤﴾

“A nuk e di se çka ka krijuar (Allahu), Ai është i Butë, i Gjithinformuar.” (El Mulk : 14)

Urtësia qëndron në atë se: të gjithë njerëzit janë robër të Allahut. Nuk ka dallim në mes të pasurit dhe të varfrit. Por, dallimi qëndron ndërmjet njerëzve në këtë botë, sepse kjo botë nuk ka nevojë për individë të njëjtë serik. Jeta nuk mund të jetë funksionale nëse që të gjithë jemi inxhinierë ose që të gjithë bëhemi mjekë ose që të gjithë bëhemi gjykatës. Patjetër që dhuntitë duhet që të shpërndahen varësisht prej nevojave të jetesës. Secili nga ne duhet të specializohet në diçka në të cilën nuk janë të specializuar të tjerët, e, edhe tjetri duhet të specializohet në diçka tjetër, në mënyrë që unë të kem nevojë për të dhe ai të ketë nevojë për mua. Ndërlidhshmëria në mes nesh, nuk duhet të jetë në baza mbivlerësuese ose vullnetare, por duhet të jetë në baza të nevojës (për njëri-tjetrin) dhe të sigurimit të furnizimit.

Dhuntia dhe mëkëmbësia në tokë

Urtësi është se: Zoti i Lartmadhëruar i ka shpërndarë dhuntitë në krijesat e tij në atë masë sa e kërkon mëkëmbësia në tokë dhe mënyra e jetesës. Një njeriu, Allahu i ka dhënë aftësi për diçka, ndërsa tjetrit aftësi për diçka tjetër. Nga përmbledhja e të gjitha aftësive, ndërtohet shoqëria. Themi: Nëse çdo njeriu veç e veç ia përmbledhim aftësitë, do të shohim se përmbledhjet e të gjithë njerëzve janë të barabarta. Mirëpo, njerëzit e shikojnë vetëm anën e pasurisë. Kurse, ka çështje të cilat janë më të rëndësishme se pasuria, siç janë: shëndeti, morali, lumturia, harmonia familjare, begatia e furnizimit, etj.. P.sh. nëse secilën prej tyre (begatie) e shumëzojmë me dhjetë, do të

shohim se përfundimisht përmbledhjet e njerëzve janë të barabarta me njëra-tjetrën. Kështu që, në të vërtetë nuk ka asnjëri prej tyre mbivlerë, përpos me devotshmërisë.

Të mirat e jetës (artikujt elementarë)

Cilat janë të mirat e kësaj bote?

Të mira të kësaj bote janë ato me të cilat sigurohet jeta. Njerëzit janë të krijuar prej elementeve të cilat janë të shpërndarë në gjithësi. Ata të cilët dëshirojnë që të krijojnë frikë në ne, se në shekujt XX (autori këtë e ka thënë në shek. XX) dhe XXI do të ketë krizë të madhe të furnizimit me artikuj ushqimor dhe se njerëzit do të vdesin nga uria, u themi: Besimi (imani) nuk e pranon këtë logjikë boshe. Dhe varësisht sa i lartë do të jetë besimi (imani), aq do të nxitë të hulumtosh për ardhmërinë. Pse? Nga shkaku se, nëse çështjen e vendos në kendarin e besimit, atëherë e di se Ai i cili i ka krijuar krijesat, e ka paraparë edhe furnizimin e tyre, që jeta e tyre të jetë e sigurt. Mirëpo, ka dallim ndërmjet furnizimit të domosdoshëm dhe furnizimit luksoz (jetë luksoze).

Dhurues është Allahu

Zoti i Lartmadhëruar t'i ka dhënë (plotësuar) nevojat e domosdoshme të jetesës, ndërsa nëse dëshiron standard më të lartë, shfrytëzoje mendjen tënde, sepse Zoti i Lartmadhëruar ta ka dhënë mendjen, logjikën dhe lëndën në ekzistencë. Pasi që Allahu t'i ka dhuruar këto baza elementare të jetës, ti vendosi në praktike, ashtu që ta ngritësh nivelin e jetës tënde.

Zoti i Lartmadhëruar e ka vendosur Ademin a.s. për të jetuar në xhenet në një afat të caktuar për ta trajnuar dhe për ta përgatitur, dhe për këtë çështje i ka thënë:

إِنَّ لَكَ أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَىٰ ﴿١١٨﴾ وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَىٰ ﴿١١٩﴾

“Këtu nuk do të mbetesh kurrë i uritur, e as i zhveshur, nuk do të kesh etje dhe as vapë.” (TaHa : 118, 119)

(Zoti i Lartmadhëruar i tha) O Adem, ti ke furnizim për të ngrënë, për të pirë, do të kesh vendstrehim dhe veshmbathje. Me këtë e mësojmë se, furnizimet elementare të jetës janë:

Furnizimet	Argumenti
1. Ushqimi	Nuk do të jesh i uritur
2. Rrobat	(nuk do të jesh) as i zhveshur
3. Uji	(nuk do të jesh) i etur
4. Vendstrehimi	(nuk do të kesh) as vapë

ÇKA JANË FURNIZIMET?

Prodhimi shoqëror

Nëse dëshiron jetë cilësore dhe komode, siç janë: lloj-llojshmëritë e ushqimeve, lëngjeve, banesave, veshmbathjeve, atëherë shfrytëzoje mendjen tënde për të përfituar nga gjithësia e Allahut. Elementet (materialet) ekzistojnë, energjia ekziston, mendja ekziston. Çdo krizë, patjetër se vjen si pasojë e mosaktivizimit të energjisë në fushëbetëjen e jetesës. Kriza e aktivitetit e ka zanafillën në dy çështje:

E para: Përtacia në nxjerrjen (zbulimin) e begative të Allahut, të cilat ekzistojnë në ekzistencë.

Përtacia dhe neglizhenca në nxjerrjen e thesareve të Allahut në ekzistencë, vjen nga moszbatimi i thënies së të dërguarit të Allahut s.a.v.s., i cili ka thënë:

“Kërkojeni furnizimin në brendi të tokës.”

dhe në moszbatimin e thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe ecni në këndet e saj (tokës) dhe hani prej furnizimit të saj.” (El Mulk : 15)

Kur popujt i kaplon kriza, dijeni se kjo u ka ardhur si shkak i përtacisë së tyre ndaj këtyre dhuntive. Dhe pasojë e kësaj do të jetë se, edhe gjenerata e cila do të vjen pas tyre do të jetoj në varfëri, sepse gjenerata paraardhëse nuk i ka kryer detyrat e saj të cilat i kanë pasur obligim jetësor. Në qoftë se ata do t'i kryenin detyrat e jetesës së tyre, do të ishin zhvilluar si shoqëri. Ti, nëse në njërën anë shikon shpërthimin e natalitetit, atëherë në anën tjetër do të shohësh zhvillimin teknologjik, kurse ata që thonë se shkaktar i moszhvillimit është nataliteti, gabojnë, sepse në fakt shkaktari kryesor i moszhvillimit është gjenerata paraprake për shkak të moskryerjes së detyrave të tyre. *Shembull:* Nëse e marrim zbuluesin e rrymës elektrike (prej saj edhe zbulimin e mjeteve teknologjike), para asaj kohe toka është punuar me mjete të thjeshta. Punën që mund ta kryej sot një mjet teknologjik, më parë po të njëjtën punë nuk kanë mundur ta kryejnë një grumbull njerëzish.

Kështu pra, përdorimi i intelektit njerëzor në gjithësi dhe procesi i nxjerrjes (zbulimit) të fshehtësive në ekzistencë, e ka zhvilluar shoqërinë, sepse sot njeriu i përdor mjetet teknologjike dhe as nuk lodhet e as nuk mundohet, kurse nga ana tjetër me një mjet teknologjik prodhon atë që deri

dje nuk kanë mundur ta prodhojnë mijëra punëtorë së bashku. Kështu që e udhës do të ishte që me shtimin e popullsisë të shtohet edhe prodhimi shoqëror, e kjo vjen si rezultat i shtimit të mjeteve teknologjike të cilat prodhojnë paralelisht me shtimin e njerëzimit.

Kur të përhapet frika për urinë apo për krizë ekonomike apo krizë të disa artikujve, të cilat janë të ndërlidhura me shërbimet e jetës, ta dish se ka ndodhur diçka në shpirtin njerëzor.

Njeriu duke brengosur së tepërmi për rizkun (furnizimin) e sodit, mashtrohet dhe harron t'ia përgatit atë (rizkun) pasardhësve. *Shembull:* Nëse i shikon ata të cilët i mbjellin hurmat, do të shohësh se ata janë tepër të shtyrë në moshë, që me shumë gjasë nuk do të arrijnë asnjë fryt të atyre hurmave, mirëpo ata e shpenzojnë energjinë e tyre për shoqërinë, apo për gjeneratën e ardhshme, që ata të ushqehen prej atyre hurmave. Po të mbillnin njerëzit vetëm atë që vet mund ta hanë, shumë pak hurma do të kultivoheshin, me fjalë tjera, njerëzit do të privoheshin nga frytet e tyre.

Kështu pra, aktiviteti i jetës patjetër duhet të jetë aktivitet jetëgjatë. Kur Zoti i Lartmadhëruar vjen që të shëroj çështjen e tërë gjithësisë, thotë:

﴿قُلْ أَنتَ كُمْ لَتَكْفُرُونَ بِالَّذِي خَلَقَ الْأَرْضَ فِي يَوْمَيْنِ وَتَجْعَلُونَ لَهُ أَندَادًا ذَٰلِكَ رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾ ٩ ﴿وَجَعَلَ فِيهَا رَوَاسِيَ مِنْ فَوْقِهَا وَبَارَكَ فِيهَا وَقَدَّرَ فِيهَا أَقْوَاتَهَا فِي أَرْبَعَةِ أَيَّامٍ سَوَاءً لِّلنَّاسِ لَيِّلٌ ۝١٠﴾

“A me të vërtetë ju e mohoni Atë i cili e ka krijuar tokën në dy ditë dhe besoni në zota të barabartë me Atë?. Ai është Zoti i botëve. Ai në tokë bëri kodra e male të palëvizshme, i bekoi ata dhe përcaktoi në të furnizimin (për banorët) e saj në masë.” (Fussilet : 9, 10)

Kështu pra, ushqimet ekzistojnë në gjithësi, mirëpo ato ekzistojnë në të ashtuquajturën ekzistim teorik dhe jo ekzistim praktik. Koncepti **“ekzistojnë me forcë”** është se ato ekzistojnë së bashku me elementet e vlefshme për t'i zbuluar ato. Të marrim një *shembull:* Kur amvisja është në shtëpi dhe burri ia sjell shportën e artikujve ushqimorë të një muaji, duke filluar prej vajit, sheqerit, gjalpit, orizit, etj., a do t'i mjaftonte kjo gruas që burrit t'ia sjell ushqimin në formë të papërpunuar apo patjetër duhet që për çdo ditë të bëjë përgatitjen e ushqimit në kuzhinë. Pra, sikurse produktet ushqimore të cilat gjenden në shtëpi e njëjta është edhe me të mirat në gjithësi. Gjithësia i ka elementet e saj dhe mjetet për të vepruar në ato

elemente. Argument për këtë është kujdesi që bëhet për ruajtjen e ambientit dhe të hapësirave bujqësore të tokës. Pse në të kaluarën nuk kemi menduar për këtë?

Sot planifikojmë dhe dëshirojmë të zgjerojmë një plantacion të tokës, pa marrë parasysh a është në shkretëtirë apo rreth liqeneve, sot bëjmë edhe shfrytëzimin e mbeturinave nga të korrurat. Por pse kjo nuk është menduar më herët? Aty ku sheh ngushtim të furnizimit, aty do të shohësh edhe përtacinë. Nëse në një vend nuk sheh përtaci, aty do të shohësh shoqërinë aktive e cila i merr të mirat e Allahut me punën e tyre, **e pastaj ato të mira i fshehin prej tjerëve**. Kështu pra, dëmtimi në gjithësi, zanafillën e ka prej dy anëve:

E para: Përtacia në nxjerrjen e begative të Allahut në ekzistencë.

E dyta: Fshehja e begatisë nga ana e atij i cili e ka zbuluar dhe e ka prodhuar.

E dyta: Begatitë e Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَأَتَّكُم مِّن كُلِّ مَا سَأَلْتُمُوهُ وَإِن تَعُدُّوا نِعْمَتَ اللَّهِ لَا تَحْصُوهَا إِنَّ الْإِنسَانَ لَظَلُومٌ كَفَّارٌ ﴿٣٤﴾

“Nëse mundoheni t’i numëroni begatitë e Allahut, kurrë nuk mund t’i numëroni.” (Ibrahim : 34)

Kryesorja e kësaj është arsyeja se pse Zoti i Lartmadhëruar e ka filluar ajetin me **“Nëse”**, fjalë e cila në vetvete tregon për mëdyshje dhe hamendje?. Argumentin e së vërtetës së kësaj çështjeje e shohim në atë se: mjetet e statistikave në botë, ekspertët e statistikave dhe qendrat statistikore, asnjëherë nuk kanë menduar që t’i numërojnë të mirat e Allahut në gjithësi. Një statistikë e tillë kurrë nuk ka ndodhur. Mospranimi i këtij lloji të statistikës është argument se Zoti i Lartmadhëruar është i sigurtë në thënien e Tij se njerëzit janë të paaftë t’i numërojnë begatitë e Allahut. Ne kemi dëgjuar për llogaritje në çdo gjë, por nuk kemi parë llogaritje të begative të cilat ekzistojnë në gjithësi.

E vërtetë: As nuk mund të numërohen, e as nuk mund të llogariten.

Dihet se ti nuk pranon të numërosh diçka, vetëm atëher kur në mendjen tënde e di se ai numërim e ka kufirin. E, pasi që ti nuk pranon t'i numërosh begatitë në ekzistencë, tregon se, natyrshmëria jote dhe mendja jote pajtohet se nuk mund t'i numërosh. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe nëse mundoheni t'i numëroni begatitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni. Pa dyshim se njeriu është i padrejtë dhe mosmirënjohës.”

Në këtë rast e shohim fjalën **“i padrejtë”** që ka kuptimin se i merret e drejta nga pronësuesi apo pronësuesi e mban sekret atë të drejtë. Pra, kur e drejta është në vendin e vet, hiqet dhe vendoset në një vend tjetër. Kështu, i merret e drejta e atij i cili e ka atë të drejtë, dhe atëherë i bën padrejtësi vetes, sepse padrejtësia buron prej dy çështjeve:

1. Marrja e të drejtës së tjetrit;
2. Gjykimi për tjetrin për një të drejtë e cila nuk është e tij.

Kur ta dëgjojmë fjalën **“mosmirënjohës”** na shkon mendja te pabesimtari, por nëse i analizojmë ajetet e Kur'anit shohim se fjalën **“mosmirënjohës”** e sqaron ajeti tjetër:

﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ بَدَّلُوا نِعْمَتَ اللَّهِ كُفْرًا وَأَحَلُّوا قَوْمَهُمْ دَارَ الْبَوَارِ﴾

“A nuk po i sheh ata që begatinë e Allahut e kanë shndërruar me mohim dhe e kanë sjellë popullin e tyre në vendbanim të shkatërrimit.”
(Ibrahim : 28)

Kështu, ata të cilët e sjellin popullin e tyre buzë greminës së shkatërrimit janë ata të cilët begatitë e Allahut i shndërrojnë në mohim (të begative të Allahut).

Çfarë kuptimi ka shndërrimi i begative të Allahut në **mohim**!?

Mohim, do të thotë fshehje, mbulim.

Shndërrimi i begative të Allahut në mohim, do të thotë mos, hulumtim në brendi të tokës. E kjo ndodhë ose prej përtacisë ose i ka zbuluar dhe i ka arkëtuar (i ka fshehur nga tjetri). E kjo është padrejtësi. Me këtë vijnë në përfundim se, shkatërrimi në tokë vjen si rezultat i dy shkaqeve:

E para: për shkak të përtacisë për të nxjerr të mirat e Allahut në ekzistencë.

E dyta: zbulimi i disa begative të Allahut, ose mundësia për të vepruar diçka, e pastaj fshehja e këtyre begative ndaj atyre të cilët e kanë atë të drejtë për ta pasur.

Çka është angazhimi?

Elementet apo materialet (materia) të cilat i nënshtrohen vërtetimit eksperimental dhe reflektimit lëndor nuk janë asgjë tjetër përveçse reflektim (rezultat) i veprimit mbi ta. Materia nuk ka vullnet të lirë, e si rrjedhojë nuk ka as dëshira.

Zoti i Lartmadhëruar, mendjet e njerëzve i ka lënë të lira që të mendojnë, planifikojnë, eksperimentojnë, me qëllim që të sjellin dobi dhe përfitime, për këtë arsye, pa marrë parasysh a janë mendje të besimtarëve apo të pabesimtarëve, *përdorimi i mendjes* sjell rezultate, suksese dhe përfitime. E kjo është arsyeja se pse pejgamberi s.a.v.s. e ka sjellë ligjin qiellor që të jetë planprogram i jetës e cila ndërhyr dhe e kanalizojn fushën e dëshirave.

Mbrojtje kundrejt dëshirave (epsheve)

Dëshirat (epshet) krijojnë konflikt në çdo çështje. E ligji qiellor ndërhyr që t'i kanalizojn dhe t'i pengojn ato.

Kuptimi i *kanalizimit dhe ndërhyrjes në dëshira dhe epshe të njerëzve* do të thotë parandalim i ndeshjes së dëshirave (epsheve) të kundërta me njëra-tjetrën. Sepse ndeshja e dëshirave (epsheve) qon deri te krijimi i një force dëshirash (epshesh). Krijimi i një force mbizotëruese nuk i shërben shoqërisë, sepse kur një forcë e lufton një forcë tjetër dhe ndërhyr në tjetrën, hyn dhe forcohet edhe më shumë, e Allahu dëshiron që të na mbrojë nga gjërat të cilat veprojnë me dëshira (epshe), për këtë arsye ka vendosur ligj dhe rregull, dhe dëshiron që njeriu në këtë botë t'i zbuloj sekretet dhe të përfitoj. Pra, neve na është lejuar hulumtimi dhe studimi, sepse eksperimentet e tilla na sjellin dobi në shumë çështje të ndryshme. Por, për çudi, këto çështje (zbulime) po bëhen 'alibi' për të kritikuar fenë tonë, sepse ata (ateistët) po thonë: Islami është fe e cila i ndalon njerëzit (mendjet e tyre) të zbulojnë çështje të dobishme, sidomos kur janë në pyetje zbulimet e kohëve të fundit e prej të cilave përfiton dhe kanë dobi njerëzit, siç janë: zbulimi sëmundjeve të ndryshme dhe zbulimi i mjeteve të shërimit të tyre, bie fjala, mjetet e anestezisë (pengimit të dhimbjeve) të njerëzve, etj..

A ka aktivitet njeriu në këtë jetë?

Është përhapur një mendim i gabuar se, kinse muslimanët thonë: Allahu dhe islami nuk parashohin shpërblim për aktivitete të cilat sjellin zbulime edhe pse dihet se shkencëtarët e harxhojnë jetën e tyre në ato zbulime, të cilat u bëjnë dobi dhe u ndihmojnë njerëzve, ua lehtësojnë vështirësitë në punë, u ndihmojnë atyre që të prodhojnë me më pak lodhje dhe me afat sa më të shkurtë kohor.

Njeriu në jetën e tij është aktiv. Por pse njeriu në jetën e tij është aktiv? Fjala “njeri” në kuptimin e drejtë të saj ka kuptimin “njeri”, as besimtar dhe as pabesimtar. Që të dy (besimtari dhe pabesimtari) janë aktiv në jetë. Pse? Njeriu është aktiv në jetën e tij për qëllimin e tij primar, e ai është:

T’i sjell dobi jetës dhe që të mos zhduket, të jetojë vet ai dhe t’ju sjellë dobi atyre të cilët i ka në përgjegjësi (nën përkujdesje).

Kjo është çështja e primare për të cilën njeriu duhet të jetë aktiv. Nëse ti punon diçka, ajo punë të kthehet ty, dhe e merr shpërblimin për të, e shpërblimi është furnizimi (të mirat materiale) që e merr e që me të e siguron jetën.

Njeriu për të cilin ke punuar, nuk ka mundur ta punojë atë punë, për këtë arsye ka ardhur tek ti që ti të punosh për të. Përderisa ai nuk ka mundur ta punojë atë punë, ka ardhur tek ti që t’ia kryesh atë punë, dhe patjetër se ai ka dobi prej punës që ia ke kryer. Kështu, prej punës ke dobi ti që ke punuar dhe ai të cilit ia ke kryer punën. Pse të ka shpërblyer Ai për të cilin ke punuar? Të ka shpërblyer sepse për të ke punuar dhe atë punë nuk e ke punuar për vete. Kështu është edhe çështja e të shpërblyerit për punën e kryer. Shpërblimi ose i shkon drejtpërdrejtë punëkryerësit ose atij për të cilin është kryer ajo punë.

Shpërblimi i punës

Në momentin kur pabesimtari e ka zbuluar një zbulim (shkencor), a e ka pasur në mendje Allahun?

A e ka pasur në mendje që në çastin e zbulimit?

A e ka pasur në mendje Allahun në momentin kur është lodhur për atë zbulim?

Jo. Ai e ka pasur në mendje atë çka do të zbuloj ai vet, e ka pasur në mendje reputacionin, emrin e tij, autoritetin e tij, ka dashur që ta dinë njerëzit të cilët e rrethojnë atë, për këtë arsye edhe ata e kanë vlerësuar, e kanë respektuar dhe e kanë dekoruar për atë zbulim, e për këtë zbulim, etj..

Kështu pra, ai i cili ka punuar dhe ka zbuluar, për atë që ka punuar dhe zbuluar, atëherë edhe shpërblimi vjen nga ai/ata, kështu që ai ka fituar famë, dekorata, nderime dhe respekt. Tash, kur ky njeri të shkon në ditën e gjykimit, a ta shpërblej Zoti, kur në asnjë çast nuk e ka pasur në mendje Allahun dhe nuk ka punuar për të ‘mirën’ e Tij (Allahut)?. Pra, këtu qëndron dallimi në mes të besimtarit dhe pabesimtarit.

Dallimi në mes të besimtarit dhe pabesimtarit qëndron dhe në masën e të ushqyerit të vet vetes së tij.

- Pabesimtari punon për punën e tij, dhe pret shpërblim nga puna e tij, ndërsa,
- Besimtari punon për shkak se Zoti e ka urdhëruar që të punoj për veten e tij. E ai punon edhe për tjetrin i cili nuk ka mundësi ta punoj atë punë, dhe shpërblimin për këtë punë e pret nga Allahu.

Kufiri i punës

Besimtari i cili e ka në mendje Allahun, punon edhe për nevojat e tij, edhe për nevojat e tjetrit, dhe thotë: Unë i plotësoj deri në fund nevojat e mia, e çka është shtesë ajo mbetet për të paafit, për pasardhësit e mi të dobët, të cilët janë rreth e qark meje. Por parashtrohet pyetja: Kur punon, kënd e ka ndërmend?

Në mend e ka Zotin e atyre njerëzve. E, atëherë çdo punë shtesë që e bën prej urtësisë së tij, e shpërblen Allahu. Këtë çështje shumë qartë na e pasqyron Zoti i Lartmadhëruar kur thotë:

وَقَدِمْنَا إِلَىٰ مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَّنْثُورًا ﴿٢٣﴾

“E, Na paraqesin veprat të cilat i kanë punuar ata dhe Ne i bëjmë ato hi e pluhur.” (El Furkan : 23)

Që do të thotë se ata kanë punuar, por Zoti i Lartmadhëruar atë punë e ka bërë *hi e pluhur*.

Në një ajet tjetër thotë:

قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٠٣﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيَّهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿١٠٤﴾

“Thuaj: A dëshironi t’ju tregoj për punët më të dështuara. Ata të cilët, angazhimi i tyre është humbur në këtë botë, ndërsa ata llogarisin se kanë vepruar shumë mirë.” (El Kehf : 103, 104)

Ka qenë e mundur që ata ta merrnin me vete punën e tyre dhe ta marrin çmimin në botën tjetër, por për këtë është dashur që kur kanë punuar ta kenë pasur në mendje Allahun. Po ta kishin pasur në mendje Allahun, do ta kishin marrë atë çmim. Zoti i Lartmadhëruar na tregon qartë në Kur’anin fisnik, ku thotë:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَلُهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيعَةٍ يَحْسَبُهُ الظَّمْآنُ مَاءً حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُ لَمْ يَجِدْهُ شَيْئًا وَوَجَدَ اللَّهَ عِنْدَهُ فَوَفَّاهُ حِسَابَهُ ۗ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٣٩﴾

“Shembulli i atyre të cilët mohojnë Zotin e tyre, veprat e tyre janë sikurse paraqitja e mirazhit në një kodrinë dhe i eturi mendon dhe llogaritë se është me ujë, derisa t’i afrohet atij e nuk gjen asgjë, mirëpo, befasohet kur e sheh pranë vetes Allahun dhe Ai do t’ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje.” (En Nurë : 39)

Kjo është drejtësi

“...Mirëpo, befasohet kur e sheh pranë vetes Allahun.”

Fakti që ai befasohet se gjendet pranë Allahut, tregon se ai nuk e ka llogaritur Allahun. Kjo tregon se gjatë kohës sa ka qenë duke punuar, në mendjen (qëllimin) e tij nuk ka qenë Allahu. E, pse tash pret ai prej Allahut që ta shpërblejë, kurse në ditën kur ka punuar nuk e ka pasur në mendje Allahun. Kjo (mosshpërblimi) është drejtësi. Në të vërtetë Zoti nuk ja ka humbur punën atij i cili ka punuar mirë dhe është lodhur për atë punë. Allahu e ka shpërblyer për atë punë, e shpërblimi i tij është fakti se Allahu e ka tubuar punën e tij, e ka vlerësuar dhe ia ka dhënë shpërblimin në këtë botë. Ata të cilët e kanë mohuar Zotin e tyre, veprat e tyre janë si “mirazhi”. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar nuk e ka përmendur se është i padrejtë:

إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا ﴿٣٠﴾

**“Vërtetë, Ne nuk ia humbim shpërblimin atij i cili bën vepra të mira.”
(El Kehf : 30)**

Për këtë arsye, ne themi “përsose punën tënde”. Por, çfarë shpërblimi do të kesh? Do të kesh shumë klient, do të sigurosh të mira materiale, do të kesh famë, askush nuk ta prek pasurinë tënde, etj.. Ama, dije se, nëse nuk e ke në mendje Allahun, atëherë çështja ndryshon, dhe vendi i shpërblimit të Allahut nuk është te ne (në tokë):

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا وَزِينَتَهَا نُوفِّ إِلَيْهِمْ أَعْمَلَهُمْ فِيهَا وَهُمْ فِيهَا لَا يُبْخَسُونَ ﴿١٥﴾

“Kush dëshiron jetën e kësaj bote, atëherë do t’ia kompensojmë atyre punën e tyre në të dhe atyre në të nuk do t’u mungoj asgjë.” (Hud : 15)

Atyre (jomuslimanëve) u është dhënë shpërblimi për atë punë, u është dhënë famë, reputacion, pasuri, autoritet dhe u është dhënë gjithçka.

E vërteta e furnizimit

Parashtrohet pyetja: Çka është furnizimi?

Në popull, furnizim quhet ajo prej së cilës kemi dobi. Çdo gjë prej së cilës njerëzit kanë dobi, quhet furnizim. Por, ne duhet ta bëjmë dallimin në mes të furnizimit hallall dhe furnizimit haram.

- **Furnizimi haram** është përfitim i shpejtë.
- **Furnizimi hallall** ndoshta në sy të disa njerëzve shihet si përfitim i vogël, por në të vërtetë ka mirësi të shumta, të vazhdueshme dhe të përhershme.

Njerëzit e përkufizojnë rizkun vetëm në një çështje, e ajo është *pasuria*. Ne themi: Jo! Nuk është ashtu!. Rizk është ajo e cila definitivisht e plotëson dobinë:

- dituria është rizk;
- edukata është rizk;
- personaliteti është rizk.

Neve na duhet që ta analizojmë thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَاللَّهُ فَضَّلَ بَعْضَكُمْ عَلَى بَعْضٍ فِي الرِّزْقِ فَمَا الَّذِينَ فُضِّلُوا بِرَادَىٰ رِزْقِهِمْ عَلَىٰ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَهُمْ فِيهِ سَوَاءٌ أَفَبِنِعْمَةِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ ﴿٧١﴾

“All-llahu favorizoi disa prej jush mbi disa të tjerë në furnizim. Atyre që u është dhënë përparësia (në furnizim), nuk janë furnizues të atyre që i kanë në pronësi (robërve), ata (të gjithë) janë të barabartë (furnizues kryesor është All-llahu). A mos duan të mohojnë dhuntinë e All-llahut?” (En Nahl : 71)

Pse të ketë dallime në furnizime?

Dallimi ndërmjet furnizimeve është çështje të cilën e ka dëshiruar Allahu, me qellim që njerëzit ta kërkojnë rizkun nëpërmjet rrugëve të ndryshme. Nëse një person dallohet për një çështje për furnizim, ai është veçuar nga njerëzit për atë çështje. Për këtë arsye, furnizim është çdo gjë prej së cilës përfitohet dobi. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَاللَّهُ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٩٢﴾

“Allahu furnizon cilin do, pa llogari.” (El Bekare : 213)

Ne duhet t’i qasemi konceptit dhe ta kuptojmë: çka do të thotë **“pa llogari”**?

Fjala llogari ngërthen:

1. Llogaritësin;
2. Të llogariturën.

Pasi që Zoti i Lartmadhëruar e furnizon një njeri, mbi të nuk mund të ketë forcë më të lartë.

Ne themi: Pse i është dhënë?

Zoti i Lartmadhëruar jep me fuqinë e Tij absolute. I jep pabesimtarit që të mahnitet besimtari. Mirëpo, a thua pse besimtari nuk i mendon të mirat e tij të shumëfishta?! Njeriu për të siguruar shpirtin e tij duhet ta kuptoj se:

“Allahu furnizon cilin do, pa llogari.” (El Bekare : 213)

Njeriu duhet ta kuptoj se, përveç të tjerëve edhe ai është i llogaritur në furnizim prej Allahut. Pse?

Sepse Zoti i Lartmadhëruar qartë ka thënë:

مَا عِنْدَكُمْ يَنْفَدُ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ بَاقٍ وَلَنَجْزِيَنَّ الَّذِينَ صَبَرُوا أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا
كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٦﴾ مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنَّىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهُ حَيَوةً
طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٩٧﴾

**“Ajo që e keni pranë vetës është e përkohshme, e ajo që është te All-
llahu është e përjetshme. E Ne do t’u japim atyre që ishin të durueshëm
shpërblimin më të mirë të asaj që vepruan.**

**Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë
besimtar, Ne do t’i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën
tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (En Nahl
: 96,97)**

Njeriu, pa marrë parasysh çfarë pasurie posedon, atë pasuri ai e ka të kufizuar dhe të numërueshëm, ndërsa, sa i përket Allahut, Ai posedon pakufi dhe në masë të panumërueshme. Kur njeriu ta kuptoj këtë, duhet të bëhet i sjellshëm dhe duhet ta dijë se ata të cilët e adhurojnë Allahun

shpërblehen më shumë se çfarë kanë punuar. Kjo nuk ka të bëjë vetëm për botën tjetër, por ka të bëjë edhe me këtë botë.

Kënaqësia dhe rizku

Kur njeriu furnizohet me rizk të lejuar (hallall), jeta e tij është e bekuar, e paskëtaj njeriu shkon në vendin më të mirë të botës tjetër.

Kështu pra, çdo njeri le të fitoj edukatë të tillë, që, të mos mashtrohet nëse e sheh se Allahu dikë tjetër e ka furnizuar më shumë se atë, sepse ne nuk e dimë urtësinë e Zotit për atë furnizim të tjetrit. Ne duhet ta dimë se, rizku është furnizim dhe për njeriun nuk është mjet dekorimi apo nënçmimi.

Njeriu mund të gjendet në situatën për të cilën Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهْنَنِ ﴿١٦﴾

“Sa i përket njeriut, kur Zoti i Lartmadhëruar e sprovon, e nderon dhe e begaton, thotë: Zoti im më nderoi.

Ndërsa kur e sprovon dhe ia ngushton rizkun, thotë: Zoti im më poshtëroi.” (El Fexhr : 15, 16)

Jo! Nderimi nuk është në shtim të rizkut (furnizimit). *Nderim* është shpërblimi që pason pas kalimit të testit (sprovës me furnizim) të rëndësishëm. Kalimi i atij testi qëndron në mënyrën e shfrytëzimit të atij rizku. Rizku (furnizimi) i paktë, nuk do të thotë nënçmim për njeriun sepse:

- Nderimi prej Zotit është që, njeriu, sprovën (detyrën) ta kryej ashtu siç e ka paraparë Zoti i Lartmadhëruar.
- Ngushtimi në rizk nuk është nënçmim, por bëhet *nënçmim* nëse njeriu nuk pajtohet dhe nuk e kryen detyrën ndaj asaj begatie.

Cilit i drejtohet ligjërimi?

وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِمَّنْ إِمْلَاقٍ تَحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ

“Dhe mos i mbytni fëmijët tuaj në situatë varfërie. Ne ju furnizojmë juve dhe ata.” (El Enam : 151)

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ خَشْيَةَ إِمْلَاقٍ تَحْنُ نَرْزُقُهُمْ وَإِيَّاهُمْ

“Dhe mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika se do të varfëroheni, Ne i furnizojmë ata dhe juve.” (El Isra : 31)

T’i analizojmë këto dy ajete:

Në njërin ajet Zoti i Lartmadhëruar thotë:

- **“Mos i mbytni fëmijët tuaj në situatë varfërie...”** ndërsa
- Në ajetin tjetër **“...nga frika se do të varfëroheni”**.

Dhe në vazhdim të dy ajeteve nuk ka thënë vetëm “Ne ju furnizojmë ata dhe juve” por:

- në njërin ajet ka thënë “Ne ju furnizojmë **juve dhe ata**” dhe,
- në tjetrin “Ne i furnizojmë **ata dhe juve**”.

Ajeti i parë: **“Mos i mbytni fëmijët tuaj në imlak (إِمْلَاقٍ)”**. “Imlak” do të thotë *kur faktikisht ekziston varfëria*.

Ajeti i dytë: **“Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika se do të varfëroheni (në të ardhmen).”** Kjo do të thotë se varfëria në rastin e dytë është *inegzistente në atë moment*, por ekziston frika se me lindje të fëmijëve vjen varfëria.

Kështu pra:

- Ajeti i parë u drejtohet të varfërve.
- Ajeti i dytë u drejtohet atyre të cilët nuk janë të varfër, por që frikohen se do të bëhen të varfër, nëse u lindin fëmijë.

I varfri, para se të ballafaqohet me rizkun e fëmijës është i ballafaquar me rizkun e tij. Për këtë arsye Allahu dëshiron që ta siguroj dhe ta bind se fëmijët e tij aspak nuk i marrin atij nga rizku. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Ne ju furnizojmë juve dhe ata.”** O ti i varfër! Ji i

qetë me rizkun tënd. Fëmijët asgjë nuk marrin nga rizku yt, sepse Zoti i Lartmadhëruar në rend të parë ju furnizon juve, e pastaj fëmijët e tu.

Kurse ai i cili nuk është i varfër, e mendon se me ardhjen e fëmijëve, vjen varfëria, e angazhon mendjen e tij duke pandehur se fëmijët që do të vijnë, pasurinë do ta zëvendësojnë me varfëri. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Ne ju furnizojmë ata dhe juve.”** Kjo do të thotë se furnizimi i fëmijëve prej Zotit të Lartmadhëruar vjen para se tu vjen furnizimi juaj. Për këtë arsye mos u frikësoni nga varfëria, e t’i mbytni fëmijët tuaj, sepse Zoti i Lartmadhëruar do t’i furnizoj ata dhe, ju nuk do të varfëroheni për shkak të fëmijëve.

Pasurinë nuk e pakëson lëmosha

Kënaqësi është kur pasurinë e shpenzon aty ku dëshiron. Kur e pëlqen një ushqim, atë ushqim e blen.

- Kur e pëlqen një rrobë, atë rrobë e blen. Në ato çaste ti gëzohesh duke e shpenzuar pasurinë tënde.

-Kur besimtari e shpenzon pasurinë duke dhënë sadaka apo zekat, këtë e bën sepse beson se Zoti i Lartmadhëruar do ta shpërblejë shumëfish në botën tjetër për atë sadaka apo zekat.

Kështu pra, **besimtari** kur e shpenzon pasurinë e tij në zekat, ai gëzohet, sepse ajo është vepër e botës tjetër të tij.

Sa i përket **hipokritit**, në zemrën e të cilit është fshehur pabesimi, ai nuk beson në botën tjetër dhe mendon se nëse shpenzon pasuri nuk do të përfitoj asgjë prej saj, dhe sipas parashikimit të tij, kjo çështje është vetëm humbje e pasurisë dhe asgjë tjetër. Kur ky lloj njeriu shpenzon, atij i kujtohet ‘vështirësia’ që ka hasur derisa e ka fituar, sepse pasurinë të cilën e ka fituar, mendon se e ka fituar me vështirësi, e pastaj i duhet ta shpenzoj, e ai nuk beson në shpërblimin në botën tjetër, kështu e konsideron shpenzimin *humbje*.

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të na e bëjë me dije faktin se, Zoti dëshiron që ata me rizkun e tyre të poshtërohen në këtë botë me punë, lodhje e vështirësi, e pastaj ta shpenzojnë duke mos pasur shpërblim, dhe si përfundim humbet pasuria e tyre.

E mira e tokës për kë?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٧﴾

“Çka ju jep juve i dërguari merreni dhe çka ju ndalon juve largohuni.”
(El Hashr : 7)

Sa i përket përkufizimit të çështjeve që kanë të bëjnë me mendjen dhe zemrën, peygamberi s.a.v.s. thotë:

“Për çështjet e juaja, ju e dini më së miri.”

Në bazë të konceptit të hadithit, konkludojmë se, çështjet e dunjasë janë çështje të cilat janë jashtë kornizës së urdhëresave dhe ndalesave. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Çka ju jep (urdhëron) i dërguari merreni (pranojeni) dhe çka ju ndalon largohuni.”** Mirëpo, kur i dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka thënë këtë, ai ka vendosur rregull të përgjithshëm, e cila gjithmonë ka të bëjë me planprogramin qiellor, e planprogrami qiellor i Allahut na tregon se Allahu ka krijuar gjithësinë me elementet dhe ligjet e saj, me rregullat dhe format e saj. Të gjitha këto, janë fushëveprim i eksperimenteve praktike, pa marrë parasysh ato a eksperimentohen prej besimtarit apo prej pabesimtarit?. Ato eksperimente japin fryte si për besimtarin ashtu edhe për pabesimtarin.

Dhuntia e Allahut

Dhuntia e Zotit të Lartmadhëruar është dhunti të cilën e ka paraparë për të mirën e njerëzimit, për të gjithë popujt, si për besimtarin ashtu edhe për pabesimtarin. E njëjta vlen edhe sa i përket udhëheqjes (mëkëmbësisë). Nuk ka dallim ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve, e këtë e mësojmë në ngjarjen kur Zoti i Lartmadhëruar e ka caktuar atë (Ibrahimin a.s.) për t'i plotësuar detyrat dhe për t'i shpërndarë furnizimet në tokë e pastaj Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë:

قَالَ إِنِّي جَاعِلُكَ لِلنَّاسِ إِمَامًا

“Vërtetë, Unë do të të caktoj (O Ibrahim) udhëheqës për njerëzimin.”
(El Bekare : 124)

Kjo nga shkaku se:

- ti (Ibrahim) e ke plotësuar planprogramin e Allahut; dhe
- detyrat i ke kryer në përputhshmëri me kërkesat e Allahut, e për këtë ti (e ke vërtetuar se) je i aftë për të udhëhequr dhe e meriton të jesh udhëheqës.

Pastaj Ibrahim i a.s. i ka thënë:

قَالَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي ^ط

“Edhe pasardhësit e mi.”

Ndërsa Allahu i thotë:

قَالَ لَا يَنَالُ عَهْدِي الظَّالِمِينَ ﴿١٢٤﴾

“Premtimi im nuk i ngërthen të padrejtët.”

Premtimi për furnizim

Udhëheqësia (mëkëmbësia) është premtim nga ana e Allahut, për ata që e meritojnë udhëheqësinë. Kjo çështje nuk njeh ngjyrë, racë, lloj, pasardhës, sepse ka thënë: **“Premtimi im nuk ngërthen në vete të padrejtët.”** edhe nëse janë fëmijët e tu.

Kështu pra, çështjen të cilën e ka pranuar Ibrahim i a.s. prej Zotit të Lartmadhëruar, kur ka shkuar te kodrina e tharë, pa asnjë bimë, që ta vendosë bashkëshorten e tij Haxheren dhe djalin e tij Ismailin, dhe e ka lutur Zotin që të jetë i butë me djalin e tij, të i ndihmoj bashkëshortes së tij, ashtu që t’i furnizoj me pemë, dhe ka thënë (lutje): **“Furnizoj ata me pemë, edhe kush beson prej tyre, por edhe ata të cilët nuk besojnë furnizoj.”**

Pasi që ti (Ibrahim) po i përzien udhëheqjen dhe rizkun, me imanin (besimin), atëherë dije se (Zoti i Lartmadhëruar ka thënë): **“Premtimi im nuk i ngërthen në vete të padrejtët.”** dhe me këtë premtim e ka eliminuar lidhjen e udhëheqjes dhe furnizimit me besimin (imanin).

Çështja e rizkut i ka rregullat dhe ligjet e veta:

- Toka i jep njeriut me anë të elementeve të veta;
- dielli me rrezet dhe me ndriçimin e vet;
- erërat me lëvizjet e tyre; e shumë e shumë dhurata të tjera prej Zotit.

Krijuesi dhe Mirëmbajtësi i gjithësisë, në këtë çështje i ka barazuar besimtarët me pabesimtarët. Për këtë arsye, çdo ekspertizë nuk i nënshtrohet vetëm besimit (Imanit), por i nënshtrohet çështjes së mënyrës së qasjes ndaj tokës. Kush punon, angazhohet dhe zbulon, do të ketë të mirat e tokës edhe në qoftë se është pabesimtar.

Të qenit i përpiktë me shkaqet

Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar çiftëzimin e hurmave, pra bashkëdyzimin e tyre. Dhe këtë e ka bazuar në atë se Zoti i Lartmadhëruar krijon çka dëshiron dhe Muhamedi s.a.v.s. ka menduar se është e mundur që edhe nëse nuk bashkëdyzohen hurmat, do të japin fryte të shumta, mirëpo ekspertiza shkencore e ka hedhur poshtë atë teori, sepse praktika e ka treguar të kundërtën sepse hurmat nuk kanë dhënë fryte. E, atëherë çfarë qëndrimi ka marrë Muhamedi s.a.v.s.?

Pas kësaj, qëndrimi i Muhamedit s.a.v.s. ka ndryshuar. Pra e ka kthyer çështjen në dhuntinë e Zotit të Lartmadhëruar dhe në pasimin e shkaqeve dhe përmbajtjes së shkaqeve në përpikëri, e kjo është të bërit ekspertiza dhe të përmbajturit në rregullat e materies, sepse pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Ju jeni më të ditur në çështjet e jetës suaj.”

Kjo do të thotë se, lejohet veprimi në bazë të përfundimeve që dalin prej eksperiencës, pra, në bazë të mundësisë, sepse në raste tjera si f.v., Kur është fjala për qiellin, ti nuk mund ta thyesh ligjin e tij, sepse qielli jep çdo fryt nga secili shkak dhe secili produkt. Ju angazhohuni, dhe nëse me anë të eksperimentit praktik arrini të diçka që është e dobishme dhe në interesin tuaj, atëherë veproni me të.

Pejgamberi s.a.v.s. e ka kthyer çështjen e cila ka qenë më herët *ndalesa nga çiftëzimi* dhe ka thënë: Kjo është çështje e ekspertizës praktike. Pejgamberi s.a.v.s. e ka marrë parasysh rezultatit e ekspertizës praktike, ashtu siç një dijetar e merr përsipër për ta rregulluar një çështje dhe vendos që së pari ta bëjë provën praktike vet, e me këtë themi se nuk ka kurrfarë pengese që ai të jetë i zgjedhur prej Allahut. Nuk ka kurrfarë pengese që ta marrin për bazë mendimin e tij, nëse veç ai është i njohur si i drejtë.

Çështja tjetër, për atë i cili dëshiron të zbulon ligj në jetën e tij, është që, teoria të përputhet me praktiken.

Çështjet të cilat kanë mjegulli

Për çështjet, të cilat Zoti i Lartmadhëruar i ka parë se nuk janë të drejta për njerëzit, i dërguari i Allahut s.a.v.s. i ligjëson siç i ka paraparë Ligjvënësi. Për këtë arsye, para islamit Muhamedi s.a.v.s. ka adoptuar fëmijë, pasi që adoptimi ka qenë një zakon i njohur tek arabët, por pas abrogimit nga ana e Allahut, atëherë peygamberi s.a.v.s. e ka ndryshuar në ligj tjetër, sepse me adoptim, fëmija i adoptuar është bërë fëmijë me të gjitha të drejtat, mirëpo islami e ka zhvlerësuar këtë çështje. Pse?

Sepse adoptimi, prej çështjes së dhurimit të të përkëdhelurit dhe çështjes së fitimit të së drejtës trashëgimore, kalon në një çështje tjetër, e ajo çështje është se, ai bëhet djali yt, dhe ndodh që ti ke një vajzë, e atëherë djali i adoptuar bëhet ‘vëlla’ i saj. E pastaj në bazë të adoptimit, ai e fiton të drejtën ta shohë, të ulet me të, të bisedoj me të, e atëherë çështja kalon prej çështjes së të përkëdhelurit dhe të çështjes së rizkut (furnizimit), në një çështje krejtësisht tjetër.

Mbrojtja prej dëshirave të ndryshme

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Ligji qiellor nuk ndërhyr në çështjet e juaja të cilat i nënshtrohen dëshirave, por ligji qiellor ndërhyr për të ju mbrojtur juve nga mospajtimet e dëshirave (epsheve) të ndryshme tuaja, sepse njeriu duhet të gjykojë në bazë të ekspertizave praktike.

Atë të cilën e kuptojmë dhe e mësojmë prej eksperimentit praktik, në bazë të rregullave e marrim dhe e unifikojmë dhe e zbatojmë në të gjitha rastet tjera. E, atëherë nuk ka mospajtim të dëshirave.

Për këtë arsye ne e shohim se sot kemi dy rryma:

Rryma e parë: Rryma teoriko-praktike.

Me këtë nënkuptohet se çdo njeri prezanton me teorinë e tij. Kjo është rryma praktike e cila quhet shkencë teoriko-praktike që do të thotë teori praktike.

Civilizimi në të cilin jetojmë sot është civilizim i shkencës së teorive praktike. Teoritë janë të ndërtuara mbi bazën praktike, të cilat kanë sjellë zbulime të shumta. Këto zbulime kanë rezultuar me zbulimin e sekreteve të Allahut në këtë gjithësi, që ne kemi përfituar prej tyre dhe kanë lënë gjurmë të mëdha në jetën tonë. Të gjitha këto janë teori të vërtetuara shkencërisht.

Rryma e dytë:

Është teoria e dëshirave (mendimeve). Në këto teori të plasuara, secili autor i një teorie mundohet që të pengoj teorinë e kundërt të tij. Kështu që, ai vendos barriera, kufij dhe pengesa, me qëllim që parimet e kundërta të mos jenë të suksesshme. Mirëpo tek ekspertiza praktike, secili mundohet të përvjedh dhe të rrëmbej sekretet e tjetrit, që të përfitoj prej saj.

Kështu pra, te ekspertizat praktike (vërtetimet shkencore) nuk ka dëshirë të epshit, por çështja e saj është e bazuar në ekspertizën lëndore praktike.

Urtësia e dhurimit dhe mosdhurimit

Në shumë ajete të Kur'anit fisnik Zoti i Lartmadhëruar e ka shpalosur perden e shpirtit. Ne një prej atyre ajeteve është thënia e Zotit të Lartmadhëruar ku tregon për hipokritët dhe pabesimtarët:

وَيَقُولُونَ فِي أَنْفُسِهِمْ لَوْلَا يُعَذِّبُنَا اللَّهُ بِمَا نَقُولُ

“Dhe thonë në vetveten e tyre, pse nuk po na dënon neve Allahu.” (El Muxhadele : 8)

(Dihet se) Atë që njeriu e thotë në vetvete nuk e dëgjon askush. Po të mos e thoshin këtë në vetvete ata do të thoshin: *Allahu nuk e ka zbuluar këtë në zemrat tona*. Por, ata nuk e kanë mohuar këtë ajet, nga shkak se e kanë thënë këtë në vetvete dhe se e kanë nuhatur se Kur'ani e ka zbuluar se çka ka në zemrat e tyre. Ajeti fisnik ka sjell atë se çka do të sillet rreth kokave të pabesimtarëve kur ta dëgjojnë atë.

Zoti i Lartmadhëruar nuk ka pritur që besimtarët t'i ankohen të dërguarit të Allahut për faktin se ata i frikohen varfërisë dhe furnizimit të mangët, por i është përgjigjur në këtë çështje para se t'u shkon mendja aty. Kjo i bie se, sikur Zoti i Lartmadhëruar ligjëson edhe atë që krijohet në zemra (mendje) dhe nuk lejon që të ndodh diçka e pastaj ta ligjësoj, por ligjëson para se ta paramendoj njeriu. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَإِنْ خِفْتُمْ عَيْلَةً فَسَوْفَ يُغْنِيكُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۖ إِنْ شَاءَ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

“Dhe nëse ju i frikoheni varfërisë, Zoti do t'i furnizoj ata prej të mirave të Tij, nëse dëshiron.” (Et Tevbe : 28)

Vazhdimësia e së mirës

Termi “**ijleten**” ka kuptimin e varfërisë, ndërsa vazhdimësia e ajetit “**Zoti do t’u pasuroj nga të mirat e Tij, nëse dëshiron.**” Zoti i Lartmadhëruar nuk ka thënë “**ju pasuron**” ose “**menjëherë ju pasuron**”. Por pasusi “**do t’u**” nënkupton se do të kaloj një afat kohor, por ai afat kohor nuk do të jetë tepër i afërt por edhe jo shumë i largët.

Pse?

Sepse e mira e cila do të vjen, duhet të jetë e vazhdueshme, ndërsa ajo çka është e vazhdueshme duhet t’i pasoj shkaqet, si f.v.: përfitimi i tyre në tregti me idhujtarët ose atë që Zoti do t’u mundësoj zbulimin e thesareve të tokës e cila do t’i pasuroj. E rëndësishme (në këtë rast) është se nevojitet të kaloj një periudhë kohore, punë e angazhim, për këtë arsye është përdorur pjesa “**do t’u**”.

Kështu pra, gjërat do t’i pasojnë shkaqet e tyre, ndërsa shkaqet kanë nevojë për kohë. Vërtetë: më vonë ka rënë shi në Xhidde (qytet në Arabinë Saudite), e është shndërruar në tokë bujqësore dhe agrokulturore. Njësoj ka ndodhur edhe me kodrinën e Halit dhe kodrën e Tebalit në Jemen dhe në Sanaa, ku kanë shkuar banorët e Mekes, pastaj kanë rezultuar të mirat nga vendet e çliruara islame prej xhizjes, haraxhit, etj..

Kështu që ne e shohim se fjala “**do t’u**” ka kaluar në shumë periudha të ndryshme kohore dhe edhe sot vazhdon ajo periudhë kohore, dhe do të vazhdoj deri në ditën e Kijametit.

Thënies së Zotit të Lartmadhëruar “**Nëse i frikësoheni varfërisë.**” duhet që t’i kushtojmë kujdes të veçantë, sepse kjo ka të bëjë me **frikën** për të cilën besimtari nga lakmia për të realizuar një çështje prej çështjeve të kësaj bote e dobëson çështjen e fesë së tij. Andaj, çdo njeri i cili bën mëkat nga frika se do të humb materialisht, si f.v., frikësohet se e humb pozitën e tij nëse e flet të vërtetën ose që eprori i tij hidhërohet me punën e tij dhe e largon nga puna, ne i themi: Mos u brengos, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Nëse i frikoheni varfërisë, Allahu do t’u pasuroj prej të mirave të Tij.”

E mira prej Allahut

Përderisa furnizimi është prej Allahut, dhe përderisa kjo është fjalë (premtim) e Allahut, atëherë askush nuk mund të arsyetohet se mëkaton vetëm e vetëm për ta ruajtur furnizimin (rizkun) e vetes dhe të familjes, ose që ta mënjanoj varfërinë nga vetja, sepse thënia e Zotit të Lartmadhëruar **“Nëse dëshiron”** është pika e cila gjendet në zemër sepse Zoti i Lartmadhëruar **“Ndoshta dëshiron”** **“Ndoshta nuk dëshiron”**. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe nëse i frikësoheni varfërisë, Allahu do t’u pasuroj prej begative të Tij.”** ka pasur për qëllim: “qetësimin dhe bindjen në Allahun”. E, parashtrohet pyetja: Pse Zoti i Lartmadhëruar më pastaj e ka përdorur fjalën **“Nëse dëshiron”**?

Kjo, nga shkakut që dëgjuesi (njeriu) ta ketë ndërmend se Zoti ndoshta nuk dëshiron dhe nuk i dhuron, pra nuk i jep.

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron ta mbaje lidhjen e përhershme me robin e Tij. Thënia e Tij **“Nëse dëshiron”** është qëndrueshmëria e kësaj lidhjeje sepse robi do të qëndroj në shpresën e Allahut dhe Allahu vazhdon të mbetet në mendjen e tij dhe se gjithmonë do të kërkoj kënaqësinë e Allahut dhe që gjithmonë të largohet nga mëkatet dhe gjithmonë të mbetet i devotshëm ndaj Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar ka fuqi absolute në gjithësinë e Tij. Për këtë arsye **“caktimi dhe përcaktimi i Allahut”** nuk janë bazë për të realizuar dëshirën e Tij, por Dëshira e Allahut është absolute dhe e pakushtëzuar qoftë edhe me caktimin e Allahut. Ai nëse dëshiron, e realizon caktimin, e nëse nuk dëshiron nuk e realizon caktimin, kështu është fuqia absolute në gjithësinë e Tij.

Besimtari nuk e tepron

Ka prej njerëzve që e njohin Allahun dhe Allahu ua zbulon ndonjë sekret, e që pastaj ai u lajmëron njerëzve, kështu që ai bëhet komunikues i Zotit të Lartmadhëruar, ashtu që vetëm Allahu të dihet dhe të mbetet i Dituri i sekreteve.

Përderisa Allahu është Ai i Cili e ka zgjedhur atë që t'ua zbuloj atë sekret njerëzve, atëherë Zoti i Lartmadhëruar mund ta ndryshoj atë dhe të mos ia mundësoj ndonjë personi tjetër. Kështu pra, fjala **“nëse dëshiron”** dëshmon për fuqinë absolute të Allahut në gjithësinë e Tij: Nëse dëshiron ju jep dhe nëse dëshiron nuk ju jep. Kjo është kështu nga shkakun që besimtari të frikësohet dhe të mos e teproj në një begati, e (për shkak të teprimit) që pastaj Allahu t'ia merr atë begati, sepse po ta linte begatinë absolutisht të lirë, atëherë njerëzit do ta tepronin me begatitë dhe duke e tepruar do të shkakttoheshin trazira në tokë, dhe do të mbizotëronte krimi, por dëshira e Allahut është që të ketë por edhe mos të ketë begati, sepse rezulton se:

- begatia e ka urtësinë e saj;
- po ashtu edhe privimi nga begatia e ka urtësinë e saj.

Kur me begati teprohet, atëherë Zoti i Lartmadhëruar e merr atë begati. Kujdes, kurrë mos e mendo se:

- begatia e Allahut ndaj teje, nënkupton se Allahu është i kënaqur me ty!
- dhe e kundërta, privimi nga begatia, është hidhërim i Zotit me ty.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهْنَنِ ﴿١٦﴾

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lartë dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: Zoti im më ka nderuar.

Por kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës ai thotë: Zoti im më ka poshtëruar.” (El Fexhr : 15, 16)

Kur Zoti i Lartmadhëruar e begaton një njeri, ai mendon se është i nderuar nga Allahu, ndërsa nëse i ngushtohet gjendja, këtë e mendon si pakënaqësi dhe mosnderim të Allahut ndaj tij.

Kësaj çështjeje i përgjigjet Allahu që të sqarohet ky koncept, kur thotë **“Jo, kurrsesi”**, që do të thotë as pasuria nuk tregon për nderim dhe as varfëria nuk tregon për mosnderim dhe poshtërim. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كَلَّا بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ ﴿٧﴾ وَلَا تَحَاضُّونَ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ ﴿٨﴾
وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا لَّمًّا ﴿٩﴾ وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿١٠﴾

“Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t’i ushqyer të varfrit. Trashëgiminë (e të dobëtëve) e zhatni me lakmi të pangopur dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme.” (El Fexhr : 17-20)

Begatia dhe Kriza (fatkeqësia)

Nëse pasuria ndikon që të bëhesh kriminel, atëherë ajo pasuri është fatkeqësi dhe jo begati.

Nëse ngushtimi i gjendjes ekonomike të pengon që të bëhesh kriminel atëherë ajo gjendje është fat (begati) dhe jo fatkeqësi.

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَإِطْفَىٰ ﴿٦﴾ أَن رَّأَاهُ اسْتَغْنَىٰ ﴿٧﴾

“Por, vërtetë njeriu e tejkalon çdo kufi kur e konsideron veten se është i pavarur.” (El Alek : 6,7)

Zoti i Lartmadhëruar nuk dëshiron që të të jep pasuri e që pastaj të bëhesh i ‘pavarur’ nga Allahu dhe ta teprosh, sepse kjo do të të shkaktonte fatkeqësi dhe nuk do të ishte begati. Kështu pra, thënia e Zotit të Lartmadhëruar **“Allahu do t’u pasuroj juve prej begative të Tij, nëse dëshiron.”** tregon për fuqinë absolute të Tij në gjithësinë e Tij, ashtu që të mos jetë pasuri vetëm pasuria materiale, pra vetëm pasuria materiale, por begati të jetë edhe karakteri gjithashtu. Pasuria nuk e largon edukatën qiellore dhe as nuk e largon nga planprogrami i Allahut. Këtë e vërteton thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Vërtetë, Allahu është Gjithëdijshëm, i Urtë.” (Et Tevbe : 28)

Me **“i Gjithëdijshëm”**, nënkupton se e di çështjen e dobishme për ju.

Me **“i Urtë”**, nënkupton se e vendos **“begatinë”** në vendin merititor dhe e vendos **“vështirësinë”** në vendin merititor.

Fitimi, Zhvatja (fitimi haram) dhe Kënaqësia

Pse thuhet: mëkati është fitim, dhe jo zhvatje?

Ne themi: Harami ka nevojë për reflektimin në të cilin ndeshen ndjenjat shpirtërore. Për këtë arsye edhe quhet zhvatje, sepse:

- kur ti qëndron në shtëpinë tënde me bashkëshorten tënde, qëndron i qetë me të. Përderisa
- nëse qëndron me një grua të huaj, atëherë pjesët e trupit tënd çorientohen dhe trazohen, ato ndeshen në trupin tënd, ashtu që i mbyll dritaret, nëse cingëron zilja e shtëpisë trembesh , flet me zë të ulët që të të mos dëgjoj askush. Këto ndjenja ndeshen në mes vete.

Njësoj është edhe kur është në pyetje pasuria hallall dhe haram:

- Nëse e ke pasurinë hallall, e shfaqë para njerëzve.
- Nëse dikujt vjedhësi i ka vjedhur diçka nga kuleta, shpirti i vjedhësit menjëherë tronditet, fillon të hulumtoj një vend të errët dhe të fshehtë ku nuk e sheh askush që të numëroj çka ka vjedhur dhe hulumton të gjej një vend që t'i fsheh mjetet e vjedhura dhe të mos i sheh askush.

Kështu pra, në hallall ka harmonizim, e që quhet fitim, ndërsa në haram ka reflektim e që është zhvatja (harami).

Mirëpo ne e shohim se Zoti i Lartmadhëruar e përdor fjalën *fitim* në vend të fjalës *zhvatje*. Ta dish se, kur Allahu e përdor këtë term, na tregon për ata të cilët e bëjnë princip mëkatimin, sa që mëkatet nuk kanë kurrfarë rëndësie dhe kurrfarë ndikimi, madje zemrat e tyre janë lidhur ngushtë me mëkatet, sikurse ata të cilët gjatë ditës me mburrje tregojnë se çka kanë bërë natën, ata pandehin se me mëkate kanë fituar.

Njeriu i cili në zemrën e tij e ka besimin, nëse bën mëkat tronditet dhe fillon të qaj dhe frikësohet se mos po e kupton dikush tjetër për mëkatën e tij.

Kështu pra, ai i cili e bën princip me mëkate, ai është ndërlidhur me mëkate dhe (fitimin haram) e konsideron fitim dhe i shumëzon mëkatet derisa të bëhet xhehenemi vendstrehim i tij dhe derisa të bëhet banor i së keqes.

Çka është kënaqësia e Zotit?

Kënaqësia e Zotit është të qetësuarit e zemrës në një çështje me të cilën lakmon që prej saj të kesh dobi.

Kur them: “Unë jam i kënaqur me këtë çështje”, do të thotë se sasia e dobisë me të cilën e arrij prej saj, më mjafton.

Ndoshta në krahasim me atë që ke arritur ti, ndonjë tjetër ka arritur edhe më shumë, por tjetri nuk është i kënaqur me atë çështje, mirëpo besimtari gjithmonë është i kënaqur me caktimin e Allahut, sepse ai i cili ia ka caktuar është Allahu i mëshirshëm.

Allahu i Lartmadhëruar është i mëshirshëm në çdo caktim të Tij, përkundër asaj se ne në disa raste nuk e perceptojmë atë mëshirë.

Ndoshta Allahu më pengon të kem pasuri, nga shkak që ajo pasuri të mos kalojë në duart e fëmijëve të mi, e që ata prej asaj pasurie të kalojnë në rrugën e keqe, si p.sh., në përdorimin e drogës, në lojëra të fatit, ose në klube të natës ku veprohen haramet. Kështu, pengimi që të mos kemi pasuri është mëshirë dhe pengimi nga dhurimi është vet dhurimi. Për këtë arsye thuhet:

Nëse nuk e arrin atë që e dëshiron, kënaqu me atë që ke arritur sepse ashtu siç ka urtësi në begati, ka urtësi edhe në pengimin nga begatia.

A KEMI TË BËJMË NE NË ÇËSHTJEN E BEGATIVE
DHE TË MIRAVE?

Obliqueshmëria e besimit është permanente

Zoti i Lartmadhëruar i obligon besimtarët që imani i tyre të jetë i përgjithmonshëm, që të besojnë në Allahun, në të dërguarin e Tij, në librat të cilat kanë zbritur prej Tij, te peygamberët e Tij, pra të besojmë në librat e mëhershëm qiellor të cilat u kanë zbritur peygamberëve.

Nëse ajo e cila ekziston kërkohet, duhet ta dimë dhe ta perceptojmë se ajo e ekzistuar është permanente dhe që obliqueshmëria për të besuar duhet të kalojë prej një gjenerate në një gjeneratë tjetër pandërprerë.

Ne mund ta kuptojmë lutjen e zotërisë sonë Ibrahimit s.a.v.s.:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَدًا ءَامِنًا وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ الثَّمَرَاتِ مَنْ ءَامَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

“O Zoti im, bëje këtë vend të sigurt dhe furnizoj me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Zotin dhe në ditën e gjykimit.” (El Bekare : 126)

Lutja e zotërisë sonë Ibrahimit a.s. na sqaron se ai në lutje i ka përmbledh që të jenë të furnizuar vetëm ata të cilët besojnë në Zotin dhe në ditën e gjykimit.

Ibrahimi a.s. bëri lutje, që furnizim të kenë fëmijët (pasardhësit) e tij besimtar dhe kërkoi që të furnizohen me pemë e perime vetëm ata. Kjo ka qenë zgjuarsia në pranimin e obliqueshmërisë nga Allahu. Kjo ka qenë edukatë e kultivuar nga mësimi prej Allahut, mirëpo mëshira e Allahut nuk ndalet vetëm në këtë çështje.

Në begatinë e Allahut ka mëshirë

Pasi që Zoti i Lartmadhëruar e ka informuar Ibrahimin a.s. se ka mundësi që mëshira e Allahut të përfshijë edhe besimtarin edhe pabesimtarin, Allahu i i ka dhënë kuptim tjetër asaj e cila ka pasur kuptim të mëhershëm:

قَالَ وَمَنْ كَفَرَ فَأُمَتِّعُهُ قَلِيلًا ثُمَّ أَضْطَرُّهُ إِلَىٰ عَذَابِ النَّارِ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ ﴿١٢٦﴾

“Tha: Kush nuk beson, do ta lë që të kënaqet pak, pastaj do ta hedh në zjarr të xhehenemit. Nuk ka vendbanim më të keq.” (El Bekare : 126)

Zoti i Lartmadhëruar e ka njoftuar Ibrahimin a.s. se:

Pasardhësit e tij besimtarë do të kenë furnizim në këtë botë dhe xhenetin në botën tjetër dhe ata do të kenë udhëheqje në këtë botë nëse kanë principe dhe karakter, përderisa:

Furnizimi material siç janë ushqimi dhe pija, këto janë begati edhe për besimtarin dhe pabesimtarin, vetëm se pabesimtari do të dënohet në botën tjetër.

Kjo i bie, sikur t’i ketë thënë Ibrahimit: Unë kur i kam vendosur në këtë botë, kam vendosur edhe besimtarin edhe pabesimtarin dhe ua kam nënshtruar gjithçka ka në tokë edhe besimtarit edhe pabesimtarit. Përderisa e kam vendosur edhe besimtarin edhe pabesimtarin, patjetër që secilit prej tyre do t’ua siguroj mjetet e jetës dhe ekzistencës.

Zoti është Furnizuesi

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِذِ اسْتَسْقَىٰ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ فَقُلْنَا اضْرِبْ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ فَانْفَجَرَتْ مِنْهُ اثْنَتَا عَشْرَةَ عَيْنًا قَدْ عَلِمَ كُلُّ أُنَاسٍ مَّشْرِبَهُمْ كُلُوا وَاشْرَبُوا مِن رِّزْقِ اللَّهِ وَلَا تَعَثُوا فِي الْأَرْضِ مُمْسِدِينَ ﴿٦٠﴾

“Kur Musau kërkoi ujë për popullin e tij. Ne i thamë: Bjeri gurit me shkopin tënd! Atëherë nga guri shpërthyen dymbëdhjetë burime dhe secili fis e dinte burimin e vet. (Ne thamë) Hani e pini prej begative të Allahut dhe mos u sillni keq e të bëheni prej shkatërrimtarëve.” (El Bekare : 60)

Kur ka mbetur në shkretëtirë populli i Musaut a.s., Zoti i Lartmadhëruar u dërgoi mjegulla që t'i mbrojë nga nxehtësia e diellit, pastaj Zoti i Lartmadhëruar iu përgjigj lutjes së Musaut a.s. për ujë. E frymëzoi që me shkop t'i binte gurit dhe kur i ra, nga guri shpërthyen dymbëdhjetë burime, po aq sa kishte fise populli i Musaut a.s. dhe secili fis e dinte burimin e vet dhe shkonte te burimi i vet për ujë.

Kështu, Zoti i Lartmadhëruar na sqaron se i përgjigjet lutësit të gjendjes së vështirë.

Lutja e Musaut a.s. ka qenë për shkak të gjendjes së vështirë.

Lutja e Musaut a.s. ka qenë për shkak të gjendjes së vështirë sepse në shkretëtirë nuk ka ujë. Ai i cili gjendet në situatë të vështirë e kupton se shkaqet janë harxhuar për këtë arsye i drejtohet Zotit të tij.

Pranimi i lutjes së atij i cili gjendet në vështirësi

Kur për shkak të gjendjes së vështirë njeriu i lutet Allahut, Allahu i përgjigjet lutjes së tij.

Shumica e njerëzve mendojnë se Zoti nuk iu është përgjigjur lutjeve të tyre. Atyre ua përsërisim këtë thënie: Zoti Lartmadhëruar i përgjigjet lutjes së atij i cili gjendet në gjendje të vështirë dhe që i janë harxhuar të gjitha

shkaqet të cilat Zoti ia ka lënë në dispozicion, mirëpo disa njerëz e lusin Krijuesin për komoditet dhe jo për nevojë.

Zoti i Lartmadhëruar i përgjigjet personit i cili gjendet në vështirësi, ashtu që ia tejkalon vështirësinë dhe pavarësohet me atë që i ka dhënë Allahu.

Besimtari, pasi që Allahu ia tejkalon atë vështirësi, është ai i cili nuk e tepron me padrejtësi. Zoti tregon për padrejtësinë e njeriut i cili nuk ka besim (iman) në zemrën e tij, kur thotë:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنَّاظٍ ﴿٦﴾ إِنَّ رَأَاهُ أَسْتَفْهَىٰ ﴿٧﴾

“Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndjen veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zoti yt.” (El Alek : 6, 7)

Njeriun pa besim, padrejtësia e tërheq zvarrë ashtu që ai e imagjinon se vështirësia e cila i është larguar, ka ndodhur prej shkaqeve të cilat i disponon njeriu. Atij i pasqyrohet se shkaqet janë burim i largimit të vështirësive, përkundër asaj se Zoti është Ai i cili e ka krijuar njeriun dhe po Ai i ka krijuar të gjitha shkaqet. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar na e tërheq vërejtjen me shembullin e popullit të Musaut i cili pasi që është gjendur në vështirësi (krizë) ka kërkuar ujë, i cili është baza e furnizimeve, kur thotë:

“Hani dhe pini nga furnizimi i Allahut.”

Zoti i Lartmadhëruar e mëson popullin e Musaut pas sprovës së vështirësisë së kërkimit të ujit, pasi që Zoti është dhurues i furnizimit dhe besimtari duhet t’i pranoj begatitë e Allahut, të bëhet falënderues dhe jo mohues. Falënderimi ndaj Krijuesit nuk bëhet vetëm me fjalë, por bëhet me fjalë dhe me vepër, për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar e vazhdon thënien e tij të njëjtit ajet:

“Dhe mos u sillni në tokë me arrogancë duke u bërë shkatërrimtarë.”

Falënderoje Zotin

Zoti i Lartmadhëruar ia mëson njeriut mënyrën e falënderimit, që ajo të jetë me vepra të mira, me fjalë të mira. Zoti dëshiron të mirën për njeriun. Njeriut, pa e ditur, mund t'i shtohen mirësitë dhe përgëzimet. Mund t'i ndodh ashtu siç i ka ndodhur popullit të Sebeit, të cilët janë mashtruar dhe kanë menduar se i posedojnë të gjitha shkaqet. Këtë e tregon Kur'ani kur thotë:

لَقَدْ كَانَ لِسَبَإٍ فِي مَسْكَنِهِمْ ءَايَةٌ جَنَّتَانِ عَنْ يَمِينٍ وَشِمَالٍ كُلُّوا مِنْ رِزْقِ رَبِّكُمْ
وَاشْكُرُوا لَهُ ۖ بَلَدَةٌ طَيِّبَةٌ وَرَبِّ غَفُورٌ ﴿١٥﴾ فَأَعْرَضُوا فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ سَيْلَ الْعَرِمِ
وَبَدَّلْنَاهُمْ بِجَنَّتَيْهِمْ جَنَّتَيْنِ ذَوَاتِىٔ أُكُلٍ خَمْطٍ وَأَثَلٍ وَشَيْءٍ مِّن سِدْرٍ قَلِيلٍ ﴿١٦﴾
ذَٰلِكَ جَزَيْنَاهُمْ بِمَا كَفَرُوا ۖ وَهَلْ نُجَازِيٓ إِلَّا الْكَفُورَ ﴿١٧﴾

“Vendbanimi i Sebeit ishte një shenjë e qartë për banorët e tij, dy kopshte, në të djathtë dhe në të majtë të lumit. (Ne u thamë atyre) Hani nga ato që ju ka dhënë Zoti juaj dhe falënderojeni Atë. I mrekullueshëm është vendi juaj dhe Falës i madh është Zoti juaj. Por ata kundërshtuan (fjalët Tona), prandaj Ne lëshuam mbi ta ujërat e pendës, dhe dy kopshtet e tyre ua zëvendësuam me kopshte të tjera, me frute të hidhëta marine dhe pak lotus. Ne i ndëshkuam kështu për shkak të mohimit dhe mosmirënjohjes së tyre. Vallë, a dënojmë Ne tjetërkënd përveç mosmirënjohësve.” (Sebeë : 15-17)

Vendbanimi i popullit të Sebeit ka qenë në Jemen. Kanë pasur dy plantacione të mëdha të gjelbëruara, një në anën e djathtë të tyre dhe një në anën e majtë të tyre. Kur'ani, nëpërmjet ajeteve fisnike na tregon se atyre u është perkujtuar që të hanë nga furnizimet e Zotit të tyre dhe u është kërkuar që të falënderojnë për begatitë, mirëpo ata janë zhytur thellë në detet e mashtrimeve dhe kanë menduar se begatitë të cilat i kanë poseduar janë si rezultat i shkaqeve që ata i kanë prodhuar. Ata kanë ndërtuar penda, ku është akumuluar sasi e madhe e ujit. Me këtë ata kanë menduar se ata janë prodhues të atij uji.

Duke i shfrytëzuar ato dy plantacione të mëdha prej të cilave kanë konsumuar ujin dhe janë ushqyer, këta banorë i janë nënshtruar vetmashtimit njerëzor, e cila është rrugë e humbjes së njeriut. Ata kanë

menduar se i posedojnë të gjitha shkaqet dhe nuk kanë pranuar se çdo gjë i nënshtrohet dëshirës së Zotit të Lartmadhëruar. Kështu populli i Sebeit është larguar nga të përmendurit e Allahut. Janë vetmashtuar duke u treguar mendjemëdhën timer, duke u mburrur me arritjen e atyre begative, e veprat e tyre, nga veprat e mira janë shndërruar në vepra shkatërruese.

Në fillim ka shpërthyer penda dhe uji i shkapërderdhur ka shkatërruar çdo gjë që ka pasur në tokë. Dy plantacionet e mëdha janë bërë të kalbura, e që më parë kishin pasur pemë të mira. Toka prodhonte vetëm fruta të hidhëta dhe pemë të cilat nuk japin fryte. Kështu i dënon Zoti ata të cilët i mohojnë begatitë e Allahut dhe nuk e falënderojnë Krijuesin, i Cili është Bujar.

Begatitë janë vetëm prej Allahut

Kështu pra, njeriu duhet të edukohet me cilësinë e falënderimit ndaj Krijuesit, i Cili është Bujar.

Njeriu besimtar duhet të jetë falënderues nga dhurimi i begative, ashtu që të mos barazohet me pabesimtarin, për të cilin Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ الضُّرُّ دَعَانَا لِجَنبِهِ أَوْ قَاعِدًا أَوْ قَائِمًا فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُ ضُرَّهُ مَرَّ كَأَن لَّمْ يَدْعُنَا إِلَى ضُرِّ مَسَّهُ كَذَلِكَ زُيِّنَ لِلْمُسْرِفِينَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٢﴾

“Dhe kur njeriun e kaplon e keqja, atëherë Na lutet shtrirë ose ulur ose në këmbë. E, sapo Ne ta largojmë të keqen, vazhdon rrugën, thujse nuk Na është lutur për fatkeqësinë që e ka goditur. Kështu u zbukurohet puna që kanë punuar atyre që i tejkalojnë kufijtë e teprimit.” (Junus : 12)

Njeriu i cili nuk beson, e kujton Krijuesin e tij vetëm atëherë kur të i ndodh diçka që i dhemb në shpirt ose pasuri, dhe, kur ta ndjen veten të dobët, atëherë i lutet Zotit në të gjitha pozitat, si duke ecur, ashtu edhe ulur, por edhe shtrirë. Që nga momenti kur Zoti i përgjigjet lutjes së tij dhe ia tejkalon vështirësinë, ai e harron begatinë e Allahut. Kështu shejtani ia zbukuron rrugën e humbjes pabesimtarit i cili nuk besonte me sinqeritet në Krijuesin Bujar.

Ai i cili nuk beson në Zotin, mendon se rruga për të arritur te begatitë bëhet duke i përshkruar Zotit idhuj dhe mendon se tjetër kush pos Zotit i dhuron të mira dhe begati. Po cili është përfundimi i tyre? Përfundimi tyre është zjarri.

Zoti im, Ti je i Urtë dhe ke mundësi për çdo gjë

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِي يَوْمٌ لَا بَيْعٌ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفْعَةٌ ۖ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٥٤﴾

“O ju të cilët keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësim! Pabesimtarët me të vërtetë janë keqbërësit e vërtetë.” (El Bekare : 254)

Ne e dimë se çdo formë thirrjeje prej Zotit të Lartmadhëruar e cila fillon me: **“O ju besimtarë”** tregon se pas kësaj vjen urdhri për t’u obliguar ai i cili beson në Zotin. Nuk është obligueshmëri për gjithë njerëzimin sepse Zoti i Lartmadhëruar nuk obligon ata të cilët nuk e besojnë, por i obligon ata të cilët e besojnë. Kush e zgjedh besimin dhe i bindet plotësisht Allahut, ai ka imunitet që Allahu ta urdhëroj, për këtë arsye lexojmë fjalën e Zotit:

O ti i cili më ke besuar Mua si Zot të Urtë, të Plotfuqishëm, Ligjvënës, Unë dëshiroj nga ti që ta kryesh këtë urdhër.

Të besuarit në Zot është mënyra e të kryerit të çdo obligimi prej Allahut. Askush të mos thotë: Pa dyshim se Zoti më ka urdhëruar me këtë detyrë për këtë urtësi apo për atë urtësi. Jo!

Besimtari thotë: Allahu, të cilit i kam besuar më ka urdhëruar me këtë ligj. Ai është Zot i Urtë, i Plotfuqishëm dhe më urdhëron vetëm për të mirën time, pa marrë parasysh a e kuptoj apo nuk e kuptoj. Ndonjëherë besimtari e zbaton urdhrin me të cilin është urdhëruar edhe pse nuk e ka kuptuar urtësinë më shumë se ai i cili është urdhëruar, ka besuar dhe e ka kuptuar urtësinë e atij urdhri. **Shembull:** Çështja e largimit të njeriut nga alkooli, a bëhet pse mjeku i thotë se alkooli ta prishë mëllçinë?

A mund të barazohet ky largim i këtij njeriu nga alkooli me besimtarin i cili është larguar nga alkooli, sepse urdhri për t'u larguar nga alkooli është prej Krijuesit të tij? Jo!

Largimi i personit të parë (pabesimtarit) nga alkooli, edhe pse është dëgjueshmëri ndaj Allahut, është bërë sepse njeriu i njëjtë me të i ka thënë të largohet. Për këtë arsye, të besuarit e tij në këshillën e mjekut është më i lartë se të besuarit në Zotin e tij dhe në Zotin e mjekut të tij.

Furnizimi prej të mirave të tij

Besimtari i cili është larguar nga një çështje vetëm pse Allahu e ka urdhëruar të largohet, ai e ka besimin e plotë dhe kur e kupton se alkooli ia prish mëlçinë, atëherë ai i bën sexhde Allahut, sepse ai e ka arritur mëshirën e Allahut pa e vërtetuar. Për këtë arsye besimtarët kur të dëgjojnë urdhrin e Allahut, që të shpenzojnë (në sadaka dhe zekat) ata këtë urdhër le ta dëgjojnë me vëmendje. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O ju të cilët keni besuar, shpenzoni prej asaj që ju kemi furnizuar juve.”

Zoti na sqaron neve, se Ai nuk kërkon nga ne që të shpenzojmë diçka që posedojmë ne, por Zoti na e bën me dije se çdo gjë që posedojmë është e Tij. Begati me të cilën jemi furnizuar prej të mirave të Tij, sepse:

- rizku vjen prej aktivitetit të njeriut;
- aktiviteti i njeriut ka nevojë për energji;
- energjia aktivizohet në lëndën e materies;
- ky aktivitet kërkon të funksionoj me logjikë;
- ne e dimë se logjika është e krijuar prej Allahut;
- organet e trupit të cilat janë të krijuara prej Allahut veprojnë sepse urdhërohen prej mendjes, e cila është e krijuar prej Allahut.
- dora e cila lëvizë, gjuha e cila flet, këmba e cila ecë, të gjitha këto, por edhe pjesët e tjera të trupit janë disa prej dhuntive të cilat Allahu ia ka dhënë njeriut.

Sa për ilustrim, nëse i marrim bimët (të lashtat), elementet të cilat gjenden në tokë dhe të cilat depërtojnë në farën të cilën e mbjellë. Ky bujk, a e ka menduar me mendjen e tij se këto i ka krijuar Allahu?. Allahu është planifikues dhe e shohim se farën të cilën e mbjell bujku në arë është efektive dhe reflekton në tokën kur elementet janë të lagura dhe atëherë

mbinë fara. E gjithë kjo, me mirësinë që e ka dhënë Allahu. Përkundër kësaj, Zoti nuk thotë se kjo begati nuk është e prodhuar prej aktivitetit (punës) të njeriut, por Zoti në tërësi ia përshkruan nderit të njeriut dhe kërkon që vetëm një pjesë të saj ta ndaj për të kontribuar për mirësi në gjithësi:

“Nuk dëshiroj nga ju furnizim dhe nuk dëshiroj të më ushqeni.”

Allahu e kërkon një pjesë prej pasurisë tënde që ta ndash dhe ta shpenzosh për vëllanë tënd të varfër. Kujdes, mos thuaj: Pasuria ime dhe të varfrit, sepse varfëria është aksidentale, e aksidentalja mund të të kaplojë edhe ty, dhe ti o njeri, nuk mund të japësh gjithmonë, mirëpo është caktim që ti ndoshta bëhesh dhënës dhe dhurues.

E drejta e të dobët

O musliman!

A nuk po e mendon se si nganjëherë Zoti i Lartmadhëruar e ka caktuar me ligj që të kërkoj nga ti të japësh, mirëpo,

Një herë tjetër Zoti i Lartmadhëruar e ka caktuar që do të vjen koha që kërkon nga tjetri që të të jep ty.

Me këtë Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të largoj dëshpërimin nga zemrat e besimtarëve, që të mbjell dashuri dhe të i forcoj besimin në zemra.

Kur tani flas për të ndarë një pjesë të pasurisë nga i afti tek i paafiti, unë e kam për qëllim për dobësinë dhe paaftësinë natyrore, pra kur nuk ka fuqi dhe mundësi të punojë, e kam për qëllim paaftësinë e profesionit dhe përtacinë dhe neglizhencën. Dobësia në këtë rast është për qëllim kur njeriu nuk ka mundësi të punoj asgjë, për të siguruar veten dhe familjen. Në këtë rast, Zoti i Lartmadhëruar e urdhëron të fortin që t'i jep të dobët. Kur e sheh i forti, se Zoti e ka begatuar që ta ndaj një pjesë të pasurisë dhe t'ia ofroj të dobët, besimtarit i kujtohet se, mund të vijë një ditë që të bëhet i dobët dhe Allahu mbjell në zemrat e muslimanëve të fortë domosdoshmërinë e dhënies për besimtarin i cili ka qenë i fortë, por që është bërë i dobët. Kjo krijon atmosferën e ndihmës reciproke, ku secili e do të mirën e të tjerëve. Kur njeriu e sheh begatinë e rizkut të njeriut tjetër dhe se një pjesë e asaj begatie shkon te ai, dhe kur ajo begati vjen te ti e shijon ëmbëlsinë që Allahu ta ka mundësuar që t'i ndihmosh vëllait tënd dhe kështu realizohet bashkëpunimi shoqëror i besimit dhe sigurimi shoqëror.

Vlera e begatisë

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O ju të cilët keni besuar, shpenzoni prej asaj që ju kemi furnizuar.”

Këtu, Zoti i Lartmadhëruar na kujton për begatitë e Tij që na ka dhënë. Kjo i bie sikur të na thotë: Begatia Ime ndaj juve është në atë se e çmoj dhe i respektoj gjurmët e punës suaj dhe them se është e juaja dhe kur vëllai juaj ka nevojë, them:

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضَاعِفَهُ لَهُ أَضْعَافًا كَثِيرَةً وَاللَّهُ يَقْبِضُ وَيَبْصُطُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢٤٥﴾

“Kush do t’i jap Allahut një huazim të bukur, që Ai t’ia kthej me shpërblim të shumëfishtë. Allahu ngushton (rizkun) dhe e liron, tek Ai do të ktheheni.” (El Bekare : 245)

Zoti i Lartmadhëruar shpenzimin e pasurisë në rrugën e Tij e ka konsideruar huazim prej robit të Zotit i Cili është Krijuesi, i Cili dhuron çdo furnizim. Thënia e Zotit për ne është qortim dhe tërheqje e vërejtjes për veprim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِيَكُمْ يَوْمٌ لَا بَيْعَ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفْعَةٌ ۚ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٥٤﴾

“O ju të cilët keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë dita (e gjykimit) në të cilën nuk ka as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësim. Pabesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.” (El Bekare : 254)

Shpenzimi i pasurisë

Zoti i Lartmadhëruar na e tërheq vërejtjen neve që të shpenzojmë nga furnizimi i Tij para se të vjen dita kur nuk do të ketë shitblerje, që do të thotë atë ditë nuk ka mundësi (hapësirë) për t'i këmbyer mallrat (mall me mall, të holla me mall dhe e kundërta). Në atë ditë nuk ka aleancë me askënd, nuk ka dashuri aq të madhe dhe të singertë në mes të dy personave, ashtu që secili prej tyre të ketë lidhje të singertë dhe dashuri të ndërsjellët, sepse secili është i ndarë prej tjetrit. Nëse jeni të ndërlidhur dhe keni simpati për njëri-tjetrin në botën tjetër secili do të jetë i angazhuar me çështjet e vetes së tij.

Nevojtarët për Allahun

Zoti i Lartmadhëruar është i Plotfuqishëm, Dëgjues dhe i Ditur. Të gjitha atributet e Tij janë absolutisht të përkryera. Për këtë arsye, në Vetvete, Ai është i Pasur dhe i Pavarur nga çdo krijesë, por që krijesat janë ata të cilët kanë nevojë për Allahun, kanë nevojë për fuqinë e Tij, kanë nevojë për çdo begati. I vetmi Allahu është Ai i cili jep prej gjurmëve të fuqisë së Tij tek robërit e Tij.

Ti mund t'i ndihmosh të dobët të që t'ua bartësh barrën të cilën nuk mund ta bartin. Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar ka mundësi që vet atë të dobët, ta bëj të fortë. Kështu është me krijesat. I afti prej neve mund t'i ndihmoj të paaftit që ta kryej një punë të cilën nuk do të mund ta kryente, mirëpo në fund ai është i paaftë ndërsa ti i aftë, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar është i vetmi i Plotfuqishëm që mundet që prej fuqisë së Tij t'i dhuroj krijesave.

Gjurmët e fuqisë së Tij i shohim në planetë të cilat i shohim në hapësirën tonë, siç janë: Dielli, hëna dhe trupat e tjerë qiellor. Njeriu nuk ka të bëjë asgjë me trupat qiellor, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar u ka dhënë atyre forcë dhe energji që t'i kryejnë detyrat për t'i shërbyer njeriut.

Allahu jep prej fuqisë së Tij

Zoti i Lartmadhëruar i ka përgatitur njeriut gjëra të shumta. Ia ka përgatitur gjithë këtë gjithësi që të jetë në shërbim të tij (njeriut).

Zoti i Lartmadhëruar:

- prej fuqisë së Tij i ka dhënë mundësi njeriut që të punoj atë punë, dhe
- prej diturisë së Tij ia ka mundësuar njeriut të mësoj dituri të cilën nuk e ka ditur, dhe
- prej pasurisë së Tij ia ka mundësuar njeriut që të posedoj në këtë botë.

Kështu pra, gjurmët e cilësive të tyre (njerëzve) nuk mund t'i transferojnë te të tjerët. Cilësia në këtë rast mbetet ende cilësi e fortësisë, ndërsa tjetri ende mbetet në cilësinë e dobësisë, mirëpo i vetmi Zoti është Ai i cili mund t'i japë prej fuqisë së Tij të paaftit dhe prapë është po Ai Fuqiploti.

Bota është dy llojesh:

E para: Bota në të cilën Allahu i dhuron (njeriut) diçka, pa pasur ndikim puna e njeriut.

Kjo botë është jashtë sferës së mundësisë së njeriut. Për këtë arsye, çështjet në të janë të qëndrueshme dhe nuk ka shtrembërime në ta: Qielli dhe çka ka në të, Dielli dhe rrezet e tij. Hëna dhe planetët, yjet, erërat. Të gjitha këto i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të plotë, të saktë dhe precize. Në ta nuk ka çrregullim dhe as zbrazëti.

E dyta: Bota në të cilën njeriu punon dhe ka ndikim në të.

Kjo është jeta jonë në tokë. Nëse dëshirojmë që jeta jonë të jetë e qëndrueshme, patjetër duhet që të veprojmë në bazë të planprogramit të Allahut. Ky planprogram i cili është vendosur nga Krijuesi i gjithësisë është i përkryer, nuk ka të meta dhe nuk lejon shkatërrime. Nëse njerëzimi i cili jeton në këtë gjithësi i nënshtrohet planprogramit të Allahut nuk do të shkaktoheshin trazirat dhe nuk do të kishte shkatërrime. Kjo, nga shkak se shkatërrimi ndodhë atëherë kur njeriu e ka në dorë atë që duhet të ndodhë. Përderisa në atë që njeriu nuk e ka në dorë (kompetencë) është e përlogaritur në mënyrë precize dhe në formë të plotë dhe të përkryer.

Kështu pra, ajo çka e shkakton shkatërrimin është veprimi i njeriut me program tjetër përpos planprogramit të Allahut në atë që i rrethon ato. *Shembull*: Lexojmë Suren Rrahman në të cilin Zoti i Lartmadhëruar thotë:

الرَّحْمَنُ ۝ عَلَّمَ الْقُرْآنَ ۝ خَلَقَ الْإِنْسَانَ ۝ خَلَقَ الْإِنْسَانَ ۝

“I Gjithmëshirshmi, ua ka mësuar Kur’anin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.” (Err Rrahman : 1-4)

Çdo gjë është e përllogaritur

Çdo krijesë është përllogaritur preciz, ashtu që i përmbush të gjitha përllogaritjet e tua në ato krijesa dhe ti të jesh i bindur në precizitetin e veprimtarisë së tyre. Kështu janë planetët, sepse ato janë të krijuara me sistem harmonik dhe preciz ashtu që ti të krijosh bindje të plotë në ta në përllogaritjet e tua.

Nëse dëshirojmë t’i rregullojmë dhe t’i stabilizojmë çështjet;

Nëse dëshirojmë që t’i rregullojmë çështjet ashtu siç janë të rregulluar dhe të harmonizuar në gjithësi trupat qiellor në hapësirë për ne, për të funksionuar për ne;

Nëse gjithësinë e shikojmë dhe mendojmë si diçka jashtë planprogramit të Allahut dhe tentojmë të ligjësojmë në bazë të mendjeve tona, atëherë këtë botë e kaplon shkatërrimi. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Pastaj Ne juve ju kemi bërë udhëheqës në tokë.”

Si është e mundur të jetë njeriu udhëheqës në tokë.

Bëhet ashtu që Zoti i Lartmadhëruar bën çka ka në tokë ta dëgjojë njeriun që të veprojnë siç dëshiron ai (njeriu):

- Mbjell, dhe toka e dëgjon duke i dhënë fryte të cilat janë në shërbim të tij.
- Ia zbulon fshehtësitë e gjithësisë, ashtu që e bën që ajri të jetë në shërbim të fluturimit të aeroplanëve.
- Atmosfera e bën bartjen e frekuencave të zërit prej një skaji në skajin tjetër të tokës.

Njeriu i pason shkaqet dhe shkaqet i japin të shkaktuarat dhe i përgjigjet atij, sikurse të ketë qenë njeriu krijues i tyre. Mirëpo, kur këto gjësende i janë përgjigjur njeriut, ai filloi të krijojë bindje se ai është krijues i tyre dhe

është vetmashtuar dhe besoi se ai krijoi pemët dhe perimet, edhe pse ai asgjë nuk posedon nga prodhimet e pemëve dhe perimeve pos fushës, sepse fara është ushqim të cilën e ka krijuar Allahu deri sa t'i forcohet kërcelli. Ara, në vetvete ka përbërjen e ushqimit të cilin e ka krijuar Allahu që ta ushqej bimën që të zhvillohet deri sa të jep frytin. Të gjitha këto nuk janë prodhimtari e njeriut, por i përgjigjen kërkesave të njeriut sepse Allahu i ka nënshtruar dhe i ka bërë që t'i përgjigjen njeriut dhe t'i japin njeriut.

Ti nuk ke të bësh asgjë në begatitë të cilat t'i jep Allahu

Për të na e tërhequr vërejtjen në këtë fakt, Zoti i Lartmadhëruar ka krijuar dy lloje të krijimtarisë:

- Lloji i cili reflekton, pa bërë ti asnjë veprim.
- Lloji i cili reflekton, kur ti vepron me të dhe jep produktin e dëshiruar, por nëse ti nuk vepron, nuk jep asgjë. Kjo është ajo që vepra juaj të mashtrohet kur reflekton në ty.

Çfarë ndikimi ke ti në diellin, përderisa kur lind, me rrezet dhe dritën, të jep atë çka është e domosdoshme për jetën tënde?

Çfarë ndikimi keni ju me veprimin e juaj, në shiun i cili zbret nga mjegullat?

Çfarë ndikimi keni ju me veprimin e juaj në erërat?

Nëse të gjitha këto reflektojnë pa veprimin tënd, ta dish se në sendet tjera të cilat të japin ty, të japin me urdhrin e Allahut, mirëpo me ndryshimin e dhurimeve, të japin varësisht prej punës tënde. Nëse e punon tokën mirë, të jep prodhim të mirë, nëse nuk e punon mirë, nuk të jep asgjë. Këtu *dhënia* është edhe për besimtarin edhe për pabesimtarin, edhe për të devotshmin edhe për mëkatarin.

Allahu nuk i thotë diellit, rrezon për besimtarin dhe mos rrezon për pabesimtarin.

Nuk i ka thënë tokës që nëse në ty mbjell besimtari jepi fryte, sepse gjithësinë të cilën e ka krijuar Allahu, e ka krijuar me ligje të cilat i mbikëqyrë dhe ka siguruar ekzistencën për të gjithë njerëzimin, besimtarë dhe pabesimtarë.

Ka krijuar shkaqet e jetës, shkaqet e sigurisë së vazhdueshme të jetës. Allahu e ka lejuar rizkun për të gjithë njerëzimin, për besimtarët dhe për pabesimtarët, mirëpo besimtari dallohet në atë se, nëse i pason shkaqet e

jetesës i jep në këtë botë dhe në botën tjetër, pra besimtari e ka edhe këtë botë edhe botën tjetër.

Dhe në fund Atij i mbështetem

Furnizim është ajo prej së cilës kam dobi, që do të thotë, çdo gjë prej së cilës njeriu ka dobi është rizik-furnizim, si p.sh.:

- Edukata e mirë është (furnizim);
- Dëgjimi i diturisë është;
- Karakteri është;
- Butësia është;
- Sinqeriteti është.

Mirëpo, furnizimi (rizku):

- ndonjëherë vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë, që do të thotë se vjen në atë mënyrë që dobia është e drejtpërdrejtë, dhe,
- ndonjëherë tjetër furnizimi (rizku) nuk sjell dobi në mënyrë të drejtpërdrejtë, por sjell diçka tjetër e cila sjell dobi në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shembull: Kur është e mira e drejtpërdrejtë e rizkut. Të hollat (monedhat) janë rizk, por janë që sjellin dobi jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse ndonjëherë njeriu mund të jetë tepër i uritur dhe me vete të ketë një kodër me ari. Në atë moment, nëse një njeri i thotë këtij: A po e pranon një bukë në kundërvlerë me kodrën e arit. Njeriu i uritur e jep një kodër ari vetëm për një bukë, sepse njeriu nuk mund të hajë ari. Kështu do të vepronte edhe i eturi, një kodër me ari do ta jepte për një gotë ujë.

Kështu pra, nuk kërkohet furnizimi (paraja) në vetvete, por njeriu e kërkon atë çka është mjet për diçka tjetër.

Rizku i cili është mjet për diçka tjetër, për të në botën tjetër ti nuk ke nevojë, sepse atje jeton pa kurrfarë shkaqe, sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë *bëhu dhe aty për aty bëhet*. Njeriu, në xhenet nuk ka nevojë për kuaj të llojit të mirë sepse aty nuk do të luftosh apo të veprosh ndonjë punë tjetër me të. Çdo gjë që të nevojitet në botën tjetër, Allahu ta jep pa shkaqe, por, në këtë botë duhet nëpërmjet angazhimit dhe pasimit të shkaqeve. Sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

قُلْ أُوتِيتُكُمْ بِخَيْرٍ مِّنْ ذَٰلِكُمْ ۖ لِلَّذِينَ اتَّقَوْا عِندَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرَى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَأَزْوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ وَرِضْوَانٌ مِّنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ



“Thuaj: A dëshironi gjëra më të mira se kjo? Për ata që janë të devotshëm, te Zoti i tyre do të ketë kopshte, nëpër të cilat do të rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe kënaqësi nga Allahu. Allahu i sheh robërit e vet.” (Ali Imran : 15)

Zoti i Lartmadhëruar na ka treguar se në botën tjetër rizku vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërsa, sa i përket rizkut të kësaj bote, Zoti nuk e sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ne e duam pasurinë, sepse pasuria na mundëson që në këtë botë t'i realizojmë blerjet e gjësendeve. Kurse, shpërblimi në xhenet në botën tjetër, në të cilën do të hyn besimtari, do të jetë ndryshe sepse aty ai gjen çdo gjë që ia dëshiron shpirti. Banorit të xhenetit, çdo gjë që i shkon në mendje, do ta ketë menjëherë aty pranë.

Mbështetja në Allahun

Mbështetja në Allahun është çështje e zemrave dhe jo veprim i pjesëve të trupit. **Pjesët e trupit veprojnë, zemrat mbështeten në Allahun.** Për këtë arsye, patjetër duhet të përqendrohemi në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Vetëm Atij i jam mbështetur.”

Pse nuk është përdorur forma “**i jam mbështetur Atij**”?

Ne themi: Ti nëse thua, i jam mbështetur filanit, atëherë ti i je mbështetur atij, por edhe dikujt tjetër, që do të thotë është e mundur ta simpatizosh më pastaj, por nëse thua **“Vetëm Atij i mbështetem”** iu ke mbështetur vetëm Atij, pa i bërë as shok dhe as rival. Rasti identik përmendet në “Suretul Fatiha” ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Vetëm Ty të adhurojmë”** dhe nuk ka thënë **“të adhurojmë ty”** sepse thënia **“Vetëm Ty të adhurojmë”** ka kuptimin se Adhurimi i tërësishëm dhe i plotë i bëhet Allahut dhe në atë adhurim nuk i bashkëngjitet dikush tjetër pos Allahut.

Ti, kur t’i mbështetesh Allahut, në të vërtetë ti i je mbështetur Zotit tënd dhe Zotit të kësaj gjithësie, i Cili të ka nënshtuar ty çdo gjë, bile edhe ato çka janë jashtë mundësive tua, siç janë: dielli, shiu, erërat, etj., të cilat fuqi në gjithësi i ka nënshtuar që të të shërbejnë ty. Dhe këtë gjithësi e ka bërë që të funksionoj për ty. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar na ka mësuar që të themi:

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ



“Vetëm Atij i mbështetemi dhe Ai është Zot i arshit të madh.” (Et Tevbe : 129)

E gjithë ajo që e kemi folur për krijesat dhe për gjithësinë të cilën e ke para dhe që ta ka nënshtuar dhe botën që e sheh dhe nuk e sheh (të cilën nuk e di) të gjitha këto janë pronë e Allahut, ashtu që i bën të gjitha çështjet të jenë nën fuqinë e Zotit të Lartmadhëruar.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të gjithësisë

Përmbajtja

ZOTI KA KRIJUAR GJITHËSINË DHE KA PARAPARË FURNIZIMET PËR TË.. 3

Për çka do të pyesin njerëzit?	5
Besimi	9
Pastrim (kujtim) nga pakujdesia (harresa).....	13
Të mirat e jetës (artikujt elementarë).....	16

ÇKA JANË FURNIZIMET?

Prodhimi shoqëror.....	21
E vërteta e furnizimit.....	30
Pasurinë nuk e pakëson lëmosha.....	34
E mira e tokës për kë?.....	35
Urtësia e dhurimit dhe mosdhurimit.....	39
Fitimi, Zhvatja (fitimi haram) dhe Kënaqësia.....	44

A KEMI TË BËJMË NE NË ÇËSHTJEN E BEGATIVE DHE TË MIRAVE?47

Obligueshmëria e besimit është permanente.....	49
Zoti është Furnizuesi.....	51
Zoti im, Ti je i Urtë dhe ke mundësi për çdo gjë	55
Vlera e begatisë	58
Nevojtarët për Allahun.....	59
Dhe në fund Atij i mbështetem.....	63